



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 11 maj 2018, në mbledhjen e VII (shtatë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç z.Afrim Shabani dhe znj.Fatlume Jaha të cilët munguan.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës së Podujevës, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi pjesëmarrjen, dhe shtoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj se e keni marrë me kohë të gjithë, me pikat e rendit të ditës jeni të njoftuar po ashtu si dhe në hyrje të kësaj mbledhje sigurisht që keni marrë konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF e mbajtur një ditë më parë, andaj pa humbur kohë mund të fillojmë me punë.

z.Fatmir Rudari, theksoi, kërkoj që në kuadër të rendit të ditës të përfshihet si pikë e rregullt, pika, pyetje përgjigje. E shtroj këtë kërkesë sepse kamë parë që një pikë e tillë po praktikohet në shumë komuna dhe atë para pikës të ndryshme, si dhe për faktin që ne vazhdimisht po bëjmë pyetje në seanca të Kuvendit por përgjigje nuk po marrim asnjëherë, andaj nëse ka mundësi për këtë seancë ose në seancat e radhës pika, pyetje përgjigje, të bëhet pikë e rregullt e rendit të ditës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne kemi Rregulloren e punës së Kuvendit e cila përcakton këtë çështje ku përgjigjet duhet të jepen drejtpërsëdrejti ose me shkrim nga drejtorët e Drejtorive përkatëse, të cilët mendoj se janë të obligueshëm të kthejnë përgjigje me shkrim ose me gojë, qoftë aty për aty qoftë në seancën e radhës, si dhe mendoj që kjo duhet të përfillet nga ana e drejtorëve e që duhet edhe të insistojmë për një gjë të tillë. Prandaj konsideroj se për gjëra që rregullohen me Rregulloren e punës së Kuvendit nuk kemi nevojë të miratojmë diçka sepse ajo veç parashihet me një akt të miratuar dhe në fuqi. Nëse nuk keni diçka unë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e KPF-së e mbajtur një ditë më parë.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me shumicë të votave të këshilltarëve të Kuvendit miratohet rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur një ditë më parë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, sigurisht ju kujtohet të gjithëve kur ne në një mbledhje në pikën të ndryshme kemi bërë kërkesë për raportin e prokurimit për periudhën qershor – dhjetor 2017, raport të cilin nuk e kemi akoma. Nëse jeni të zotët dhe nëse keni informacionet e duhura, përgjigjeni këtu. Unë mendoj se pika e propozuar nga këshilltari parafolës është shumë me rëndësi sepse sigurisht që ne do të parashtrojmë pyetje dhe do të interesohemi për çështje që kanë të bëjnë me interesin e qytetarëve dhe për shërbimet që do t'ju bëhen atyre. Prandaj kërkoj të hedhet në votim kërkesa që pika, pyetje dhe përgjigje, të përfshihet apo jo në rend të ditës përkatësisht të jetë pikë e rregullt në këtë seancë dhe në seancat e radhës. Pastaj ne jemi në dijeni se kemi të drejtë të thërrasim në interpelancë secilin drejtor dhe të tjerët për çështje të caktuara. Pra mendoj se jeni të gatshëm të përgjigjeni për atë që keni bërë ose jo, ose keni bërë mirë ose keq.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, unë paraprakisht e sqarova se si është e rregulluar kjo çështje, por megjithatë është propozim dhe vazhdojmë me procedurën e votimit rreth këtij propozimi.

16 vota ishin për,

mirëpo para se të vazhdohet me votimin, kundër dhe të përmbajtur, kërkohet fjala nga propozuesi i kësaj pike.

z.Fatmir Rudari, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, ideja e pikës së propozuar vjen si shkak i asaj që në mbledhjen e parafundit unë kam kërkuar një sqarim rreth Klubit të Futbollit “Llapi”, dhe asnjëherë nuk kam marrë përgjigje deri tani, por jam i interesuar sepse kam qenë anëtar i një komisioni të formuar në mandatin e kaluar. Pastaj kemi shumë pyetje të parashtruara nga këshilltarët tjerë e që asnjëherë nuk është dhënë përgjigje nga askush, andaj para pikës, të ndryshme, pikën, pyetje dhe përgjigje, e kanë shumë Komuna tjera, Prishtina etj, thjesht ne parashtrojmë pyetje drejtorët përgjigjen, nëse ka mundësi, nëse jo vazhdojmë, por e përsërisë që ne po parashtrojmë pyetje vazhdimisht kurse përgjigje nuk po marrim asnjëherë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e hedh në votim rendin e ditës sipas materialit të dërguar. Nuk di çka ka të paqartë këtu ngase ne dëgjuam propozimin e këshilltarit, pastaj e sqarova se kjo rregullohet me Rregulloren e punës së Kuvendit, por konform procedurave e hedha në votim dhe e vërejtët se nuk pati votat e nevojshme, andaj mos të përsëriten gjërat dhe mos të humbim kohë pa nevojë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, propozimi i kolegut z.Fatmir Rudari ishte konkret, por nuk do të thotë që pika e propozuar të jetë në këtë seancë. Ne faktikisht në KPF e kemi miratuar rendin e propozuar të ditës që kjo mbledhje të mbahet me pikat sipas thirrjes dhe materialit të kësaj mbledhje. Pra kërkesa ishte që të përfshihet në rend dite pika, pyetje përgjigje, që mendoj se është shumë demokratike dhe nuk ka asgjë, por edhe nëse bëhen pyetje në atë seancë dhe drejtori përkatës nuk ka përgjigje aty për aty atë mund ta jap në mbledhjen e radhës, për këtë jemi në dijeni se drejtorët tani për tani nuk kanë materialet përkatëse për të dhënë përgjigje menjëherë, andaj mendoj se nuk është ndonjë problem që në seancat e radhës të hynë kjo pikë në rend dite, gjë të cilën po e votojmë ne si Grup i këshilltarëve, pra ne shtrojmë pyetje kurse drejtorët e Drejtorive përkatëse nëse kanë përgjigje mund të përgjigjen aty për aty nëse jo mund të përgjigjen në seancën e radhës e që mendoj se ka mjaft kohë rreth një muaj për tu përgatitur secili prej drejtorëve, pra mos të bllokohemi në këtë çështje por të vazhdojmë me punë sepse një pikë të tillë e praktikojnë edhe shumica e Komunave të Kosovës. Ne jemi në dijeni për çështjet që rregullohen me Rregulloren e punës së Kuvendit, por jemi edhe në dijeni se Kuvendi ka kompetenca të merre vendime për çështje të caktuara, andaj lidhur me kërkesën në fjalë mendoj se shkon në të mirë të

drejtorëve të Drejtorive për një transparencë më të madhe, gjë që po të isha në vendin e juaj do të thosha po menjëherë fute në rend dite, apo po të isha drejtor i ndonjë Drejtorie menjëherë do të pranoja një pikë të tillë, madje do t'u përgjigjesha aty për aty secilit prej këshilltarëve. Si do që të jetë, ne këtë mbledhje duhet ta vazhdojmë por ndoshta është e nevojshme edhe një konsultim me Grupin e juaj rreth kësaj kërkesë – propozimi, mund të bëjmë një pauzë të shkurtër 3 minuta në mënyrë që të bëhen konsultime.

Me pajtim të shumicës së këshilltarëve të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit jep pauzë 3-5 minuta (brenda sallës), për konsultim mes shefave të Grupeve të këshilltarëve.

Pas pauzës, fillon mbledhja...

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne patëm një konsultim mes vete shefat e Grupeve të këshilltarëve rreth pikës që ishte propozim i këshilltarit z.Fatmir Rudari. Ishte mendim i të gjithëve që përgjigjet duhet të jepen nga ana e drejtorëve të Drejtorive, e që deri tani disa përgjigje janë dhënë disa jo. Nga ky konsultim qëndrim i të gjithë shefave mbeti që për mbledhjen radhës dhe mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, pika në fjalë, të shqyrtohet si pikë e rendit të ditës, sigurisht edhe subjektet politike secili veç e veç, pastaj në mbledhjen tjetër do të vendosim se si do të mbetet kjo çështje, ne si propozues u pajtuam me këtë, por ishte edhe Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së të cilët ende nuk kishin bërë konsultime mes vete dhe ishin hezitues për çështjen në fjalë. Pra në mbledhjen e radhës do të konsultohemi për këtë propozim, edhe pse e mbështesim dhe i qëndrojmë mbrapa përfshirjes në rend të ditës një propozim të tillë për arsye se është mirë të bëhen pyetje dhe të jepen përgjigje, kështu që në këtë mbledhje mendoj se nuk është mirë ta bllokojmë më tutje për këtë temë, e pastaj në mbledhjen e ardhshme të KPF-së ku janë prezent edhe shefat e Grupeve të këshilltarëve e diskutojmë këtë propozim dhe marrim një qëndrim. Kështu ishte qëndrim i shefave të Grupeve të këshilltarëve.

Kryesuesi i Kuvendit, nënvizoi, vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës sepse rendi i ditës veç u miratua pak më herët.

1. Ekstraktet e Procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më; 28 shkurt 2018, 09 mars 2018 dhe 28 mars 2018

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në këtë pikë kemi të bëjmë me tri Ekstrakte të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, materialet i keni marrë me kohë andaj nëse ndokush nga këshilltarët ka diçka rreth tyre urdhëroni, nëse jo mund i hedh në votim, në pako tri Ekstraktet e procesverbaleve, nëse jeni të pajtimit.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan pa vërejtje Ekstraktet e Procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 28 shkurt 2018, 09 mars 2018 dhe 28 mars 2018.

2. Raporti Financiar për periudhën janar – mars 2018

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave - DBF, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, si obligim ligjor që është e paraqesë para këtij Kuvendi këtë raport financiar për periudhën janar - mars 2018 i cili ka për qëllim prezantimin e aktiviteteve financiare të zhvilluara gjatë periudhës në fjalë, me theks të veçantë do të paraqesë informatë të shkurtër lidhur me

shpenzimet në nivel komunal sipas kategorive ekonomike dhe sipas burimeve prej nga ato mjete janë shpenzuar dhe duke bërë një krahasim të të gjitha llojeve të shpenzimeve me periudhën e njëjtë të vitit 2017, të cilat janë cekë edhe në materialin e dërguar.

Në vazhdim drejtori theksoi shumat e shpenzuara sipas kategorive ekonomike duke bërë krahasime edhe me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, shpenzime të bëra këto në kuadër të planifikimeve për këtë periudhë e që krahasuar me vitin paraprak për këtë periudhë për të cilën tha se kemi një rritje prej 5%. Në vazhdim theksoi, sa i përket të hyrave vetanake për periudhën në fjalë, janë arkëtuar 270,069.00 € ose 17% e planit vjetor, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017 kemi një rënie prej 12%. Karakteristik e këtij raporti është se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, të hyrat janë zvogëluar për 12% kurse shpenzimet janë rritë 5%.

Krejt në fund mund të konstatohet se ky raport jep një pasqyrë të qartë të të hyrave dhe të dalave për periudhën raportuese.

z.Avni Fetahu, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, këtë raport e sheh si një aktivitet të domosdoshëm dhe një praktikë të mirë për t'i mbajtur të informuar, fillimisht këshilltarët e Kuvendit por edhe qytetarët në përgjithësi. Ashtu siç e potencoi edhe parafolësi drejtori i DBF, raporti si i tillë përfshinë periudhën tremujore të këtij viti, periudhë kjo ku mjetet financiare shpenzohen jo në masë të madhe duke pasë parasysh faktin se kemi të bëjmë me zhvillimin e procedurave të prokurimit për projekte të ndryshme në interes për qytetarët e Komunës tonë, duke rikujtuar gjithnjë se raportet vijuese periodike kanë një realizueshmëri më të lartë dhe ky shpenzim i buxhetit natyrisht që realizohet sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike. Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së mbështetë këtë raport financiar për këtë periudhë tremujore të përgatitur nga Ekzekutivi i Komunës, dhe në këtë aspekt ri përsëritim edhe një herë kërkesën e Grupit tonë që edhe në mbledhjet e kaluara të kësaj legjislature e kemi përmendur disa herë ku shembull për kryerjen e obligimeve ndaj Komunës për të pasur një raport financiar më të mirë, duhet të jemi fillimisht ne këshilltarët e Kuvendit, Ekzekutivi i Komunës, punëtorët brenda saj duke përfshirë edhe ata të arsimit dhe shëndetësisë e mandej të presim edhe nga qytetarët që mos të figuroj asnjë borxh në raport me obligimet që kemi ndaj Komunës. Këtë e them për të rikujtuar çdo herë se kryerja e obligimeve tona ndaj Komunës do të thotë rritje të hyrave vetanake e me këtë edhe realizim i shumë projekteve në interes, si në fushë të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, shërbimeve publike e të tjera për qytetarët e Komunës tonë.

z.Vendenis Lahu, theksoi, duke analizuar këtë raport vërehet qysh në shikim të parë se është i përafërt me raportet e viteve të kaluara. Ky raport ashtu sikurse raportet e viteve tjera paraprake tregon për një buxhet të planifikuar jo mirë, pa politikë zhvillimore, me veprime ad-hoc dhe pa vizion. Gjithashtu ky raport nuk plotëson një prej kriterëve bazë që do të duhej ta plotësonte një raport i pranueshëm dhe i mirë, kriter i cili është transparenca dhe qartësia e raportimit. Ne si LVV e kemi bërë një analizë sistematike të këtij raporti dhe në vazhdim në mënyrë kontinuele do t'i paraqesim mendimet tona. Në buxhetin e planifikuar për vitin 2018 prej 21,372,000.00 €, përveç problemeve që ka në strukturën e shpenzimeve ku shpenzimet kapitale nuk marrin pjesë në masë të duhur raporti tregon se ka probleme më të mëdha si në realizimin e të hyrave ashtu edhe në shpenzimet kapitale. Të hyrat vetanake janë jashtëzakonisht të ulëta në këtë tremujorë rreth 17% e planifikimit apo nga 1,557,640.00 € janë realizuar vetëm 270,069.00 € e që me një analizë të thjesht matematikore nëse vazhdon ky trend i realizimit të të hyrave vetanake atëherë deri në fund të vitit do të arrihet një inkasim deri në 68%. Ajo që është edhe më shqetësuese në aspektin e të hyrave vetanake në çdo pozicion është edhe më keq se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi realizimin e tatimit në pronë i cili është 10.07% më i ulët, pastaj realizimi nga lejet e ndërtimit është 51.59 % më i ulët, realizimi nga lejet për ndërtesa është 10.15% më i ulët, pastaj të hyrat nga

qiraja janë 70.16% më të ulëta se në tremujorin e kaluar. Në kategorinë e investimeve kapitale për këtë tremujor realizimi investiv është shumë i ulët karshi buxhetit të planifikuar për këtë periudhë ku nga 6,489,514.00 € të planifikuara, në këtë tremujor janë shpenzuar vetëm 112,140.00 € apo vetëm 1.72% e buxhetit për investime kapitale. Sigurisht jemi në dijeni se tremujori i parë i vitit për investime kapitale nuk është shumë i përshtatshëm, mirëpo ky tremujorë është më i përshtatshëm për përgatitjet teknike të projekteve për fillimin e proceduarve të prokurimit dhe të lidhen kontratat në mënyrë që në muajin mars të fillohet me implementimin e të gjitha projekteve të planifikuara. Në ueb-in e E-prokurimit ne kemi shikuar dhe kemi gjetur se deri më sot janë vetëm gjashtë projekte kapitale të cilat janë proceduar për prokurim e që tregon se ky vit do të jetë jo i mbarë për investime kapitale. Edhe nga këto investime kapitale të cilat figurojnë në listën e investimeve kapitale për tremujorin e parë të vitit 2018, pjesa më e madhe e tyre janë të realizuara në fund të vitit 2017 gjatë fushatës elektorale, kemi asfaltimin e rrugës “Zahir Pajaziti” e cila ka kushtuar 15,418.00 € projekt ky i realizuar në fushatë elektorale dhe në këtë vit Komuna ka planifikuar që ta prish këtë investim ku do të ndërtohet sheshi në këtë pjesë që është asfaltuar.

Po ashtu meremetimi i rrugëve me zhavorr në vlerë prej 40,611.00 € janë realizuar gjatë fushatës nga kompania Toifor. Ne si Lëvizje Vetëvendosje nuk do ta mbështesim këtë raport.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, para vetës kemi raportin financiar për tremujorin e parë të vitit pikë kjo e cila ka filluar të jetë si pikë e rregullt nga mandati i kaluar që ne si këshilltarë të Kuvendit ta kemi pasqyrën e shpenzimeve për çdo tremujor. Në fakt si dokument i dërguar është një obligim i kryer për shpenzimet e bëra kurse për arsyetime mbetet të vlerësohet nga Kuvendi dhe ata që kanë bërë këto shpenzime. Disa vërejtje të cilat i ceku edhe kolegu nga LVV-ja për shpenzimet e vitit të kaluar por edhe në këtë tremujor nuk dëshiroj t'i ripërsëris, mirëpo përshtypje më kanë bërë e që edhe më duken shpenzime të panevojshme dhe që nuk është dashtë të bëhen në këtë tremujor të vitit sepse në qoftë se vazhdohet me këtë trend deri në fund të vitit do të merremi vetëm me shpenzime personale të zyrtarëve komunal e jo me ndonjë investim të interesit qytetarë, pra i nderuari Kryesues i Kuvendit vetëm në këtë tremujor të parë të viti janë bërë 5,200.00 € shpenzime për telefon që është një ngritje 105% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2017 dhe që mendoj se është një shumë marramendëse dhe jo e pranueshme për këtë tremujorë të shpenzohet një shumë e tillë për telefon nga ana e Ekzekutivi i Komunës, e them këtë për arsye se Kuvendi i Komunës nuk ka shpenzime të tilla, madje jam në dijeni se as ish Kryesuesi i Kuvendit në mandatin e kaluar z.Mehmet Gashi nuk ka pasur mbushje të paktën 10 € bile sa për të ftuar këshilltarët e Kuvendit në takime pune, ndërsa për Kryesuesin aktual të Kuvendit nuk jam në dijeni a ka mbushje, pra krejt këto shpenzime janë të planifikuara dhe të shpenzuara nga Ekzekutivi i Komunës dhe si të tilla janë të papranueshme madje duke marrë për bazë edhe faktin që thirrjet dhe bisedat mes vete përmes telefonisë mobile janë pa pagesë sepse ekziston marrëveshja e lidhur mes Telekomit të Kosovës dhe Komunave ku e njëjta kontratë është edhe me Komunën e Podujevës, kështu që unë nuk di se çka kanë mund të bisedojnë për tu bërë një shpenzim i tillë. Çështje tjetër është edhe dinamika e projekteve në këtë që edhe drejtori i DBF e ceku paraprakisht dhe në mbledhjen e KPF-së, e që është e vërtetë se në tremujorin e parë të viti dinamika e zhvillimit të punëve apo akterëve në terren është vështirë të punohet, por janë përgatitjet teknike për fazat e tenderimit.

Sa i përket të hyrave vetanake të inkasuara 12% për tremujorin e parë të vitit mendoj që tatimi në pronë i atyre që banojnë në fshatra nuk duhet të na brengosë aq shumë sa duhet të na brengosë kryerja e obligimeve nga neve dhe të tjerëve qoftë si zyrtarë, pastaj i qiramarrësve të pronave komunale dhe të tjerëve, e them këtë për arsye se ka rënie të thellë për këtë tremujorë. Unë jam në dijeni se të hyrat nuk është i obliguar t'i mbledh drejtori i DBF por është drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit ai i cili me të marrë detyrën është dashtë të bëjë një rishikim të punës së kaluar e

pastaj të vazhdoj me çështjet që lidhen me vitin 2018, çështje të cilën unë mendoj se duhet ta trajtojmë me një seriozitet të madh. Për shpenzimet sipas vendimeve të Gjykatës në shumë prej 25,400.00 € që janë bërë, mendoj se nuk duhet të na përcjellë vazhda e viteve të kaluara për njerëz të cilët e kanë kryer punën përkatëse, nëse kemi të bëjmë për pagesa ndaj operatorëve ekonomik të cilët e kanë kryer punën, por që nuk iu janë bërë pagesat me kohë, nëse jo është mirë të na jepet një sqarim nga drejtori i Drejtorisë përkatëse për çka janë bërë këto pagesa me vendime të Gjykatës, e them këtë sepse çdo vendim i tillë i Gjykatës e ka edhe një barrë shtesë financiare e cila duhet të paguhet, qoftë kamata kohore qoftë edhe shpenzimet e Gjykatës, shpenzime këto të cilat sa do të vogla që mund të jenë, janë të panevojshme sepse pagesat duhet të bëhen me kohë nga ana e Komunës. Pastaj në raport kam hasur në shumën e shpenzuar prej 7,300.00 € për paga për përfituesit individual dhe si jurist që jam me profesion, nuk kam mund ta kuptoj këtë shpenzim, paga për përfituesit individual, jam në dijeni se në mandatin e kaluar ka pasë paga për njerëz me kontratë mbi vepër, për njerëz të dalë në pension, paga për skadime të kontratave mbi vepër dhe që janë mbajtur serish në ato vende, raste këto që shembull, ashtu siç ka qëndruar pas pensionimit dhe që është paguar ish zyrtari i lartë i Prokurimit zotëri Hoxha, ndërsa kemi po thuajse 50 ekonomistë e 500 doktorë të ekonomisë, dhe iu bllokohet vendi i punës atyre në baza politike, për mua si shef i Grupit të këshilltarëve të PDK-së është e papranueshme, si dhe e papranueshme së pari duhet të jetë për Kryetarin e Komunës i cili e thirr dhe ndal aty personin e cekur sepse ligji i rregullon gjërat, dhe nuk jemi për bllokimin e vendit të punës ngase nuk ka mbet Podujeva në një zyrtar 65 vjeçar i cili madje nuk ka as fakultet por është vetëm me shkollim të mesëm dhe një trajnim përkatës për punën përkatëse në zyrën e prokurimit. Ne kemi kryer rreth 6 trajnime me Organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore, dhe po thuajse çdo herë na është thënë se çdo plan buxhet apo projekt tenderimi duhet të kaloj përmes Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitet në të cilin LDK-ja e ka shumicën dhe jemi në dijeni se çështjet kalojnë me vota, por asnjëherë ai ish zyrtar dhe ekspert të cilin e ka ndal Kryetari në atë vend pune, nuk ka qenë në gjendje të sjell në KPF ndonjë dokument me të cilin do të na njoftonte për planifikimet qoftë për vitin paraprak qoftë për aktual, andaj për këto arsye pagesat e tilla për ata njerëz janë të panevojshme sepse nuk janë të shëndetshme. Nuk po dëshiroj të hy edhe tek shpenzimet tjera në disa kode të cila i ceku edhe drejtori i DBF siç ishte kodi për Parqe Nacionale etj, dua të them se nuk dëshiroj të hy asgjë në kritika për shpenzime të cilat hyjnë në shërbim të qytetarëve, por për asfaltimin e rrugës “Zahir Pajaziti” në vitin e kaluar e tani që planifikohet të prishet e njëjta rrugë përgjigjen mund ta jap vetëm ai i cili ka thënë të asfaltohet dhe që tani thotë të prishet, sepse ne të tjerët nuk besoj që mund të kemi përgjigje, e them këtë sepse kur është asfaltuar ajo rrugë është thënë se po punohet, ndërsa tani kur prishet çfarë të thuhet dhe si të arsyetohen ato mjete të shpenzuara për atë rrugë. Pastaj Planin Zhvillimor Urban ka qenë i përgatitur por nuk ka kaluar në Kuvend, sa jam në dijeni shumica e Kuvendeve të Komunave nuk e kaluar një dokument të tillë. I nderuar ish drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe tani drejtor Drejtorisë së Inspeksionit, shembull, ndërtohet një objekt që synohet të inkasohen të hyra vetanake, ne veprojmë në bazë të Planit në fuqi sikurse që punojmë me ligjet që janë në fuqi sepse askujt nuk mund t’i themi vepro ashtu sepse jemi duke përgatitur një dokument i cili do të hyn fuqi pastaj. Pra me Planin Zhvillimor Urban aktual që është, lejet e ndërtimit dhe me Planin Urbanistik, kush i jep të drejtë dikujt që të ndërtoj një objekt, madje përball objektit të Komunës, katër kate më shumë se që është leja e ndërtimit, nëse drejtori në fjalë ka ndonjë përgjigje është mirë të na jap, mirëpo përgjigje i është dhënë ndërtuesit kur i është thënë se ndërto ti objektin se me Planin e ri do ta parashih kaç kate, nëse është bërë në këtë formë vota do të shkoj kundër edhe në qoftë se është në të mirë të atyre, pastaj duhet të mblidhet tatimi dhe taksat tjera, prandaj në çështje të tilla duhet të

jenë të kujdesshëm njerëzit kompetent, dhe në çështjet ku kërkohet ndihma e neve si Kuvend është mirë të ftohemi sepse ndryshe nuk mund të japim kontributin tonë, përndryshe të ndërtohet një objekt në kundërshtim me çdo normë dhe dokument në fuqi si dhe të përfundoj dhe të bëhet shitja komplet, unë ju them se nuk do ta lejoja askënd, vëlla apo kush do që ka mund të jetë ai, për arsye se dikush duhet të merr vendim dhe për arsye se drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit nuk e arsyeton pagën e vetë sepse ai paguhet për të mbajtur rend në qytet, që bizneset të funksionojnë në qytet, pastaj që ndërtuesit të kenë të drejtën e barabartë të ndërtimit në Podujevë, andaj kush i jep të drejtë një ndërtuesi të bëjë çfarë të dojë në Podujevë, dhe nëse është ashtu atëherë po dalim të gjithë po bëjmë çfarë të dëshirojmë sipas qejfeve tona. Pra i nderuar Kryesues, në këtë raport janë disa pagesa në disa pika me të cilat edhe pajtojmë, por si shkak i disa pagesave tjera ku disa veç u cekën po detyrohemi të ngritim debat dhe të japim argumente, madje propozimi për pikën, pyetje përgjigje, që ishte mu për çështje të tilla do të na shërbente e që për rastin e cekur drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit ndoshta nuk do të mund të përgjigjej përse dikush ndërton katër kate më shumë se sa lejohet me Planin Zhvillimor Urban. Unë i ngrita disa shpenzime për të cilat mendoj se janë të panevojshme, si dhe meqë ka elemente dhe buxhet për të gjitha këto shpenzime të panevojshme, pozita e Kryesuesit të Kuvendit si më e larta në këtë Kuvend, kushdo që është ai aktualisht dhe që do të vijë në të ardhmen, kërkoj ta ketë një buxhet minimal për punën e vet, nuk po lidhi për emra por për pozitë. Kërkoj falje se ndoshta paksa e zgjata këtë diskutim, por qëllimi ishte për të mirë dhe për transparencë më të madhe sa i përket shpenzimeve, mirëpo edhe njëherë e ripërsëris që rreth 6,000.00 € shpenzime për telefon për tre muaj vërtetë janë shumë, unë e di se ato mjete nuk i ka shpenzuar Kryetari, e as drejtori i DBF i cili vetëm i arsyeton dhe i ka nënshkruar ato pagesa e që nuk do ta nënshkruaja asnjëherë një shumë të tillë për tre muaj, dhe që mendoj se drejtori ka bërë keq që i ka nënshkruar ato shpenzime - pagesa.

z.Adnan Zymeri, theksoi, siç edhe është e nënkuptueshme ndër burimet kryesore për operacionalizimin e funksioneve të Komunës janë financat, të cilat na janë pasqyruar në këtë raport. Nga një vështrim i rëndësishëm i zërave financiar vërehen përputhje të planifikimeve dhe gjendjes aktuale me disa varianca krahasuese të cilat janë vazhden e lejueshme. Nga burimet kryesore të të ardhurave komunale, Komuna e Podujevës ka arrit të inkasoj rreth 300,000.00 € në këtë tremujorë të parë të vitit që paraqet një shumë të konsoliduar por që ka hapësirë për progres përkundër që rritja e përqindjes së inkasimit implikon numër shtesë të punonjësve që reflekton rritje të shpenzimeve në nënkategori tjera. Racionaliteti i shpenzimeve komunale theksohet në kode të cilat në tërësinë e shpenzimeve e kanë vlerën më të madhe, shembull, karburante për vetura, mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve si dhe dreka zyrtare. Unë besoj fuqishëm që angazhimi i përbashkët në vlerësimet e juaja me shpresë të drejtë si opozitë, do t'i siguroj bashkëqytetarëve tanë vazhdimin e menaxhimit të drejtë të kontributeve të tyre.

znj.Doruntina Hasana, theksoi, derisa dëgjoja parafolësin z.Adnan Zymeri, mendoja a kemi marrë të njëjtin raport apo jo sepse deri sa ne e kemi analizuar me vëmendje goxha shqetësues na del të jetë. E para që është shqetësuese në këtë raport del të jetë ajo të cilën e përmendi kolegu im që ka të bëjë me kategorinë e investimeve kapitale. Si mos të mendojmë se në Ekzekutivin e Komunës nuk menaxhohet drejtë madje ndoshta nuk menaxhohet fare buxheti përderisa shohim që nga 6.498.514.00 € janë të investuara vetëm 112.141.00 € që kthyer në përqindje i bie se janë investuar vetëm 1.72%, kjo na bënë të bindemi se këtu nuk ka drejtor dhe Kryetar të cilët dinë të menaxhojnë. E dyta, kur shohim shpenzimet sipas kodeve na bënë shumë për të dyshuar, shembull, shpenzime për anëtarësi 7,924.95.00 € rritje nga viti paraprak prej 256.18%, për çfarë anëtarësimi behet fjalë, ju lutem nëse ndokush ka përgjigje. Pastaj shpenzime-vendime të Gjykatave 25.402,96 € e që krahasuar me periudhën kohore paraprake që ishte 00, mund të na shpjegohet më qartë për

çfarë vendimesh behet fjalë. Kodi tjetër, regjistrimi i automjeteve 1,360.00 € rritje për 75% nga periudha paraprake, si mund të ketë rritje kaq të madhe regjistrimi përderisa nuk ka të raportuara blerje të automjeteve të reja dhe kur merret parasysh që automjetet regjistrohen çdo vit, madje në të njëjtën kohe, ketë e bën edhe më dyshuese kur shohim kodin e sigurimit të automjeteve i cili është zero, edhe këtu shtrohet pyetja si mundë të regjistrohen automjetet e të mos sigurohen ato, të gjitha këto mbeten gjera të cilat kërkojnë shpjegim. E treta dhe më shqetësuesja që është në këtë raport financiar është inkasimi i të hyrave vetanake, konkretisht inkasimi nga qiraja në përdhën kohore janar-mars 2018 ku janë inkasuar vetëm 3,626.00 € apo 70% më pak se në periudhën e njëjtë kohore paraprake, kjo tregon qartë mungesën e seriozitetit gjatë hartimit të Planit afatmesëm të të hyrave vetanake sepse realisht një plan i tillë ekziston mirëpo po del të jetë i bërë vetëm sa për sy e faqe. Ne jemi shumë të vetëdijshëm që inkasimi i të hyrave nga qiraja gjithherë ka qenë i dobët mirëpo tash se fundmi duket qartë se nuk inkasohen fare të hyra nga qiraja, këtë e themi duke u bazuar në një dokument të lëshuar nga drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë z.Abaz Llugaliu në të cilin dokument figurojnë 28 objekte të cilat janë në shfrytëzim, në të njëjtin dokument figurojnë edhe 52 lokale në Tregun e Qytetit të cilat po ashtu janë në shfrytëzim, 51 tezga në Tregun e Qytetit gjithashtu që janë në shfrytëzim që në total i bie 131 objekte komunale nga të cilat Komuna inkasonte të hyra, po i përmendim edhe 2345 prona kadastrale të cilat do të duhej të ishin në shfrytëzim e që fatkeqësisht nuk janë ndërsa Ekzekutivi i Komunës apo thënë më drejtë Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë inkason për tre muaj vetëm 3,626.00 € e që i bie vetëm 1,028.00 € në muaj, pra ky është një tregues i qartë sa inkasohen të hyra nga qiraja e pronave komunale, dhe si menaxhohen ato.

Nga gjithë kjo që u tha deri tani më shkon ndërmend t'i parashtroj tri pyetje, dhe atë: 1- më 25.07.2014 është dhënë në shfrytëzim ish lokali i Shërbimit të Kontabilitetit Shoqërorë - SHKSH i cili gjendet në rrugën "Zahir Pajaziti" objekt i cili është dhënë në shfrytëzim me çmim ofertues prej 1,262.00 € dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit është hiq më pak se 45 muaj deri sot, andaj pyetja është, sa saktë janë inkasuar të hyra nga ky objekt. 2- më 25.07.2014 është dhënë në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite objekti ish "Hotel Llapi" i cili gjendet në rrugën "Zahir Pajaziti" me çmim ofertues 1,170.00 € për muaj, gjithashtu edhe për këtë objekt kohëzgjatja e shfrytëzimit deri më sot është 45 muaj, andaj edhe për këtë është po e njëjta pyetje, sa janë inkasuar të hyra nga ky objekt, dhe 3- është e njëjta pyetje për objektin komunal "Mileniumi 2000" për të cilin jemi në dijeni se për plot 18 vite nuk i'u ka përgjigj obligimeve financiare në raport me Komunën, tani ku këtë objekt e menaxhon një pronar i ri, pyetja është, sa i ka përmbushë obligimet e tij financiare. Pyetje këto për të cilat ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së kërkojmë përgjigje me shkrim nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave brenda afat ligjor, ndryshe do t'i ndjekim rrugët tjera ligjore.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF-së, theksoi, në pika të shkurtra do të mundohem të jap përgjigje dhe sqarime të nevojshme në disa prej çështjeve të ngritura. Sa i përket shpenzimeve kapitale, është një konstatim se shuma e shpenzuar është simbolike në krahasim me buxhetin e planifikuar por sezoni dimëror përfundon me 15 prill kështu që janë kushtet jo të favorshme që edhe nëse janë lidhë kontratat nuk mund të bëhet ekzekutimi i punimeve gjatë kësaj periudhe. Këto shpenzime janë nga kontratat dy vjeçare ku për disa prej tyre kanë ekzistuar kushte atmosferike të kryhen punime dhe për detaje tjera prezent janë drejtorët e Drejtorive përkatëse të cilët mund të japin detaje tjera rreth punimeve dhe shpenzimeve përkatëse. Për të hyrat vetanake e thash edhe në fillim se janë breng e të gjithëve, madje sa herë që kam raportuar për raporte financiare e kam shpreh brengën se inkasimi i mjeteve është i dobët, çështje në të cilën ndoshta të gjithë mund të jemi të involvuar që të jemi më mirë, situatë në të cilën ndokush mund të kënaqet, por unë e them se nuk duhet të jemi të

kënaqur. Duhet ta kemi parasysh se tatimi në pronë është një obligim vjetorë, askush nuk detyrohet me ligj deri më 30 qershor të çdo viti që të kryej këtë pagesë por vetëm 50% të obligimit vjetor, kurse 50% obligohemi ta kryejmë në pjesën tjetër deri më 31 dhjetor të çdo viti, edhe përkundër kësaj janë bërë pagesa nga ana e qytetarëve, shumë kjo e cila nuk mund të themi se është e kënaqshme. Janë brengosëse të hyrat tjera për të cilat bashkërisht duhet të angazhohemi të ecim përpara dhe të bëjmë progres. U përmend edhe çështje rreth pagave për përfitues individual, çështje që ndoshta kërkohet të bëhen më së shumti sqarime, Komuna planifikon në buxhet nga të hyrat vetanake në kuadër të Drejtorisë së Administratës një buxhet nga i cili çdo punëtori - nëpunësi civil të Komunës i jepet nga një pagë me rastin e pensionimit, gjë të cilën e mundëson Rregullorja 33/2014 e nxjerrë nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe e cila zbatohet nga Komuna e Podujevës, do të thotë që secili punëtor i cili pensionohet e merr një pagë ekstra nga kategoria e subvencioneve si një lloj ndihme andaj edhe hyn si pagë për përfitues individual. Vendimet Gjyqësore, këtu i kam dy vendime të tilla ku njëra ka të bëjë me Selime Zeka e cila ka pësuar aksident në një rrugë pa dalje në rrugë kryesore dhe e cila ka paditur Komunën për shkak se nuk ka pasë shenjë sinjalizuese të komunikacionit, e cila pas disa viteve e ka fituar kontestin gjyqësor përkatësisht ka marrë një shumë të konsiderueshme të mjeteve për atë aksident të komunikacionit që ka pësuar si qytetare e Komunës së Podujevës. Vendimi tjetër gjyqësor ka të bëjë me hartimin e projektit detaj urbanistik të qytetit i cili kur është hartuar nuk ka pasur të gjitha dokumentet e plotësuar për pagesë, pastaj kjo çështje ka shkuar përmes kontestit gjyqësor dhe e ka fituar atë kontest përkatësisht e ka marrë pagesën. Sa i përket shpenzimeve për anëtarësim, janë 10 cent për kokë banori që paguhen në Asociacionin e Komunave të Kosovës, shumë e cila mund të paguhet në tremujorësh, gjashtëmujorësh, nëntëmujorësh dhe vjetor, varësisht nga mundësitë buxhetore, dhe ne si Komunë për këtë vit kemi kryer pagesë për gjashtëmujorë, shumë e cila është rreth 8,400.00 €, si dhe kemi një obligim tjetër në shumë prej 3,500.00 € në Agjensionin Zhvillimor Rajonal - Qendër e cila bashkëpunon direkt me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe me Komisionin Europian, obligim i cili është marrë në bazë të Rregulloreve dhe Vendimeve në fuqi dhe që kryhet varësisht prej mundësive buxhetore. Po ashtu u cek edhe regjistrimi i automjeteve i cili është një proces që Komuna kryen pagesa për këtë gjë posa të sjellën faturat, ndërsa sigurimi i automjeteve është me kontratë të veçantë, dhe kompania përkatëse nuk i sjellë faturat menjëherë posa të sigurohet një veturë zyrtare e Komunës, por i sjellë faturat paksa me vonesë, zakonisht sjellën faturat për 5 ose 10 sigurime të veturave që bëhen, pra është një kontratë e veçantë që bëhet nga regjistrimi i automjeteve ku pagesa bëhet në Ministrinë e Punëve të Brendshme kurse për sigurimin e automjeteve është pagesë që i bëhet kompanisë së kontraktuar nga Komuna të cilës i bëhen pagesa varësisht kur ajo i sjellë faturat e që sigurimi bëhet me kohë, do të thotë kompania kryen sigurimin sot ndërsa pagesat bëhen kur të sjellët fatura. Për lokalin ish SHKSH, sigurisht që z.Abaz Llugaliu drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë do të jetë përgjegjës për të sqaruar këtë çështje, mirëpo e vërtetë është që atë lokal e ka pas në shfrytëzim, ka pasë kontratë e cila i është ndërprerë por që obligime financiare nuk ka lënë të pakryera. Po ashtu edhe lokali ish "Hotel Llapi" sa jam i informuar është ndërprerë kontrata e shfrytëzimit por që sa jam në dijeni nuk ka kryer të gjitha obligimet në tërësi, si dhe Mileniumi i Ri ka kontratë të re që i është dhënë shfrytëzim dhe ka kryer obligimet sipas kontratës por aktualisht ka vetëm 2 muaj pa kryer obligimet, kurse kontrata e vjetër i është ndërprerë më parë dhe kjo çështje është në proces gjyqësorë, nuk është e vërtetë se nuk ka paguar kurrë për shfrytëzimin e atij lokali sepse ka paguar por jo rregullisht e për çka është në proces gjyqësor për çka presim që shumë shpejt të zgjidhet ai proces.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH, theksoi, dëshiroj që shkurtimisht t'i jap disa sqarime rreth shpenzimeve të bëra e që realisht nuk është një dinamik e madhe e punimeve në këtë rast e shpenzimeve kapitale sikurse që janë shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe për paga që është një dinamikë reale. Sa i përket DSHPMSH nga këto shpenzime 112.000.00 € që janë bërë rreth 78% i përkasin kësaj Drejtorie. Zakonisht Komunitet dhe Agjensionet tjera në tremujorin e parë të vitit paguajnë kryesisht borxhe gjë e cila po shihet edhe në këtë raport sepse në këtë tremujor nuk punohet po thuajse fare apo të themi shumë pak në investime kapitale, mirëpo sa i përket Drejtorisë në fjalë sipas planifikimeve dhe dinamikës së paraparë është mirë por nganjëherë mund të ketë ngecje për shkak të procedurave që mund të vonohen, megjithatë mund të them se brenda Drejtorisë kanë përfunduar rreth 137,000.00 € brenda kontratës si dhe 14 projekte të cilat janë proceduar, shuma është rreth 1.2 milion euro që janë në procedurë, prandaj konsideroj se jemi në dinamikë të mirë sa i përket këtij procesi.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, konsideroj se debati përfundoj për këtë pikë të rendit të ditës dhe ftoj që me ngritje të dorës të deklarohejmë për këtë raport.

Pas votimit u konstatua se me 16 vota për, 9 vota kundër dhe 6 vota të përmbajtura miratohet Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2018

3. Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, për rëndësinë e themelimit të këtij Këshilli sigurisht jeni në dijeni të gjithë dhe besoj se nuk kemi çfarë të diskutojmë, detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e Këshillit janë jashtëzakonisht të rëndësishme për Komunitetin e Podujevës. Konsideroj se jemi vonuar paksa me themelimin e këtij Këshilli, por sigurisht jeni në dijeni se vonesa është si shkak i një anëtarit nga radhët Komitetit për Komunitete përkatësisht Kryesuesit të Komitetit për Komunitete i cili pas themelimit është kthyer në rishqyrtim nga MAPL për shkak të mospërfilljes së barazisë gjinore.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Këshill ky i përbërë nga persona në bazë të përgjegjësiave zyrtare që kanë, duke rikujtuar se KKSB vepron konform Udhëzimit Administrativ i cili përcakton detyrat dhe përgjegjësit që ka, i cili natyrisht që me tu themeluar duhet që brenda një afati ligjor të paraqesë planin e veprimit për këtë vit dhe raportin e punës për vitin e kaluar, ku kemi mundësi pastaj të japim rekomandime me rëndësi për sigurinë e qytetarëve të Komunës tonë. Ne Grupi i LDK-së e përkrahim themelimin e KKSB-së sipas propozimit përkatës dhe njëherit e rikujtojmë se do ta përcjellim me vëmendje punën e tyre duke sugjeruar për çështje të caktuara që ndërlidhen me sigurinë e qytetarëve në veçanti dhe sigurinë e ambientit në përgjithësi.

z.Bajram Ajeti, theksoi, rreth rëndësisë së themelimit të KKSB-së e ceku edhe parafolësi por po e them dhe unë sepse është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ përkatës, sipas të cilit Kryetari të Komunës i jepet e drejta dhe autorizimi ligjor që të propozoj, mirëpo themelimi i këtij Këshilli është i vonuar ashtu siç jemi të vonuar me gjithçka, duke filluar me planin e Ekzekutivit të Komunës i cili nuk është sjellë fare, pastaj Kryetari nuk vie në mbledhje fare krahasuar me Kryetarët e Komunave tjera të cilët janë prezent në seanca për të dëgjuar problemet

dhe hallet e qytetarëve. Gjatë analizës së bërë në Udhëzimin Administrativ dhe duke parë emrat e përfaqësuar të cilët duhet të jenë në përbërje të këtij Këshilli me ata të propozuar në këtë propozim vendim, unë mendoj se janë tre – katër emra të cilët duhet të rishikohen për arsye se, Radisav Perović përfaqësues i Komunitetit Serb është mirë të na jepet sqarim se ky person a është banorë i Komunës apo figuron sa për të marrë 50 € dhe mjaltë edhe pse atij i duket e ithët, e them këtë sepse kemi informacione se ai person jeton në Luginë të Preshevës prandaj këtë informatë e duam sepse të gjithë jemi në dijeni se kush mund të angazhohet në një Këshill të tillë dhe që duhet të merr përgjegjësi para qytetarëve tanë. Pastaj kemi rastin e Donjeta Sheqiri, të cilën nuk e njoh por që në këtë propozim ajo përfaqëson edhe e OJQ-të, edhe Mediat lokale edhe Komunitetin e biznesit edhe Personat me nevoja të veçanta, kur jemi në dijeni se në Rregullore thuhet që secila nga këto që i ceka duhet të kenë nga një përfaqësues në këtë Këshill, por sigurisht që një përfaqësim i tillë si në këtë propozim vendim mund të bëhet vetëm në bazë të ndonjë marrëveshjeje ose memorandumit të arritur ndërmjet këtyre komuniteteve, mirëpo meqë znj. Donjetë Sheqiri nuk na garanton respektimin e nenit 15 të Ligjit për asociimin në Organizata Joqeveritare për arsye se dihet orientimi politik i të përmendurës e cila ka qenë edhe kandidate për këtë asamble, nuk do të ishte e ndershme që ajo të jetë përfaqësuese e komuniteteve në fjalë sepse nuk do të jetë në gjendje të respektoj parimin e paanshmërisë. Po ashtu jam në dijeni se procedurat nuk janë zbatuar për arsye se çdo përfaqësues i komunitet duhet të zgjidhet me vota të përfaqësuesve të secilit komunitet ashtu sikurse që kemi përfaqësuesit e komunitetit Rom e të tjerë. Pastaj është e paqartë që Qefser Behrami përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike KLSB – Kërpinëh, mandej Nuh Selimi përfaqësues i KLSB – Orllan, përse nuk është përfshirë edhe nga fshati Lluzhan sepse janë në të njëjtin nivel nëse veç këto trupa vërtetë ekzistojnë në terren. Këshilltari parafolës e ceku se ky Këshill do të na raportoj në Kuvend, mirëpo jemi në dijeni se kemi pas dy mbledhje të jashtëzakonshme, njëra për vërsimet dhe shtrohet pyetja a ka bërë diçka ky Këshill për atë ngjarje ose a ka evidentuar ndonjë gjë, ngjarje për të cilën sot e asaj dite nuk keni dhënë raport, kurse në atë mbledhje keni deklaruar se komisioni është në terren, por që po shihet se ato ishin vetëm fjalë sepse ende nuk është sjellë ndonjë raport për dëmet dhe pasojat nga ato vërshime e që ne i kemi parë e besoj edhe ju sepse kemi qëndruar në terren, dëme dhe pasoja që janë bërë si shkak i punës së keqe të investimeve kapitale për pastrim të lumenjve e që shkatërron tokën bujqësore.

Kështu që baza ligjore e themelimit të KKS-së ekziston, parashihi punë voluminoze në atë Këshill por ne do të kërkojmë llogari dhe raporte për punën e vetë e jo që vetëm të marrë 50€ mëditje, sepse fushveprimtaria e këtij Këshilli është mjaft e gjerë, dhe këtë mund ta marrim shembull vetëm çështjen e sigurisë në trafikun urban që e kemi, fushë në të cilën mendoj se duhet të involvohet ngase fundja ky Këshill themelohet edhe në pajtim me Ligjin për Policinë e Kosovës, në mënyrë që të punohet, të nxjerrët situata reale që e kemi dhe të ndërmerren masat me të cilat duhet t'jua bëjmë jetën qytetarëve më të sigurt qoftë në kuptimin fizik qoftë në kuptimin e lëvizjes së lirë të tyre.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, ne po diskutojmë për themelimin e KKS-së si një trupë e Kuvendit të Komunës që është obligative të formohet. Edhe dje në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar për këtë Këshill dhe kemi thënë se jemi me vonesë sa i përket themelimit të tij, tani jemi në muajin e pestë 2018 dhe ende nuk e kemi planin e punës së KKS-së për arsye se ende nuk është themeluar. Gjithashtu mungon edhe raporti për vitin 2017, gjë për të cilën diskutuam edhe në mbledhjen e KPF-së, për gjendjen e sigurisë, për numrin e fataliteteve, zjarreve, aksidenteve e të tjera në mënyrë që ta kemi një pasqyrë më reale rreth sigurisë në Komunën e Podujevës, mirëpo këto dy çështje mbeten edhe kompetencë edhe disponim edhe mundësi e atyre

që kanë përgjegjësi në Këtë Këshill. Jemi në dijeni se në këtë përbërje prej 15 anëtarëve disa emra janë në bazë të detyrës zyrtare siç janë Kryetari i Komunës, një numër i drejtorëve të Drejtorive, Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë, Kryetari i Bashkësisë Islame në Podujevë, përfaqësuesit e Komuniteteve jo shumicë, po ashtu përfaqësuesi i një pakice minimale i cili nuk përfaqëson asgjë po thuajse, fjala është për komunitetin Serb, përfaqësuesit të së cilës i figuron emri në këtë përbërje të KKSB-së por që realisht shumë pak brengoset për sigurinë e qytetarëve të Komunës së Podujevës, mirëpo nuk dëshiroj të lëshohem më tutje në këtë temë.

Në këtë propozim figuron edhe emri i z.Agim Blakqorit i cili si duket qenka emëruar drejtor i Drejtorisë së Arsimit, edhe pse zyrtarisht nuk jemi të njoftuar që është emëruar drejtor, por të cilit i dëshiroj punë të mbarë dhe vënie në rend arsimin në Komunën e Podujevës për arsye se kemi vërejtje të shumta për ish kolegun e juaj drejtorin paraprak. Tek anëtarja në numrin 15, duke mos dashur të përmend emra personal, mendoj që fajin kryesor e ka ai i cili është munduar që znj.Donjetë Sheqiri ta fusë anëtare në KKSB, unë personalisht nuk e njoh shumë, e di që ka qenë kandidate e LDK-së për Kuvend të Komunës së Podujevës e cila ka garuar me numrin 30, e që mendoj se shumë në mënyrë demokratike i kemi zhvilluar garat si subjekte politike, por e di që e njëjta përfaqëson LDK-së sepse ka qenë e nominuar prej këtij subjekti, edhe pse nuk ka arritë të marrë votat e nevojshme për të qenë pjesë e këtij Kuvendi. znj.Donjetë Sheqiri me katër detyra në këtë Këshill, si përfaqësuese e OJQ-ve, Mediave lokale, Komunitetit të biznesit dhe Komitetit të personave me aftësi të kufizuara dhe me nevoja të veçanta, të paktën kështu na është sjellë me dokument se këtë përfaqësim e bënë znj.Donjeta Sheqiri, por duke e ditur shumë mirë që të gjitha këto OJQ dhe Shoqata, jam i sigurt që sikurse që është sjellë në propozimin e kaluar që ka qenë një person që nuk dëshiroj t'ia përmend emrin, është bërë vetëm në mënyrë individuale, dhe për këtë jam kundër. Mendoj se është mirë që vetë kjo të tërhiqet nga ky Këshill, në mënyrë demokratike, jo pse ne jemi kundër znj.Donjetë Sheqiri, përndryshe për mua personalisht kushdo që vjen në atë Këshill në mënyrë siç duhet do ta kishte mbështetjen time. Edhe në Komisionin e ngritur më 07.05.2018 me Vendim të Kryetarit të Komunës z.Agim Veliu, znj.Donjetë Sheqiri është anëtare e komisionit për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Podujevës, e cila do të vlerësoj subvencionimin e OJQ-ve qofshin ato sportive e të tjera, e që mendoj se ky është një keqpërdorim, të paktën, i personalitetit të saj. Unë e di se kemi shumë djem dhe vajza të mira, qoftë edhe brenda LDK-së të cilët nuk janë në dijeni se kah po rrëshqasin me keqpërdorimin e kujtdo qoftë në mënyrë tendencioze. Për këtë arsye unë nuk e mbështes këtë Këshill me këtë përfaqësim, përndryshe kushdo qoftë tjetër do ta votoja për, dhe më vie shumë keq që u bë temë diskutimi emri i znj.Donjetë Sheqiri, me tendencë politike të atij ose atyre që e kanë futë në përbërje të KKSB-së por të mbetet në përgjegjësinë dhe ndërgjegjen e tyre që njerëzit i keqpërdorin në këtë formë. E them këtë për arsye se me rastin e ngritjes së trupave të tillë jemi të obliguar ta dimë se kush këndë e përfaqëson dhe të kërkojmë llogari nga të njëjtit për punën e tyre. As në mandatin e kaluar ne asnjëherë nuk kemi kontestuar ngritjen e trupave të Kuvendit që janë obligative por as të anëtarëve që janë kredibil sikurse që nuk jemi kundër shumicës së këtyre emrave të propozuar edhe pse janë të LDK-së, por në emër të OJQ-ve që është përfaqësim nga jashtë politikës duhet të jetë një njeri jo politik, madje nuk do ta propozoja dhe nuk do ta mbështetja as ndonjë person që është nga PDK-ja sepse në raste të tilla pastaj ka vetëm përfaqësim të programeve politike të partisë përkatëse, prandaj në emër të OJQ-ve dhe tejkalimit të barrierave politike duhet të jenë vërtetë ata të cilët duhet të kryejnë punët e vet në atë drejtim. I nderuari Kryesues i Kuvendit, me keqardhje, por lus që edhe LDK-ja ta shqyrtoj mirë propozimin që të bënë zëvendësimin e znj.Donjeta Sheqiri, përndryshe shumicën e votave i

keni mund të vazhdoni por nuk është mirë të kaloj ky propozim sepse do të na detyroni të merremi me këtë temë përkatësisht për punën që do ta kryej KKSB.

z.Blerim Maqastena, theksoi, kam pyetje për Kryetarin e Komunës edhe pse nuk është prezent këtu, ky Këshill a është një partiak apo është Këshill nga të gjitha subjektet politike, Shoqëria Civile dhe Komunitetet. Nëse është e para mund të them se është krejt në rregull, por nëse është e dyta dëshiroj të ndalem paksa të diskutoj rreth emrave të propozuar.

Emri i parë z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës është në rregull, pastaj me radhë vazhdojnë Bekim Bislimi Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, edhe pse është dashur të jetë i pavarur politikisht ky është përkrahës i LDK-së gjë të cilën e ka treguar edhe në zgjedhjet e tetorit 2017 në raste konkrete, Bekim Jashari përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame është në rregull, mandej është Radisav Perović përfaqësues i Komunitetit Serb për të cilin shtrohet pyetja, a duhet që vetëm ky të jetë përfaqësues në të gjitha trupat, a nuk ka tjetër apo si qëndron puna këtu, Enver Rama përfaqësues i Komunitetit Rom në rregull, Shaban Ahmeti Kryesues i Komitetit për Komunitete a ka ndokush që e ndërron këtë peron nga këto pozita sepse nga paslufta është në atë Komitet dhe nuk di çfarë pune të mirë ka bërë ky person për atë Komunitete, pastaj Naime Podvorica zyrtare për barazi gjinore LDK, Agim Blakçori drejtor i Drejtorisë së Arsimit LDK, Naim Bajraktari përfaqësues i FSK-së në rregull është, Qefser Behrami përfaqësues i KLSB – Kërpimeh, Nuhi Selimi përfaqësues i KLSB Orllan edhe ky LDK, Rizah Muqolli Kryesues i Ekipit Lokal Veprues për Siguri në Bashkësi LDK, Faik Muçiqi përfaqësues i Emergjencave Civile LDK, Liman Zeqiri përfaqësues i ZKKK edhe ky LDK, Donjetë Sheqiri përfaqësues e OJQ-ve, Mediave Lokale, Komunitetit të Biznesit dhe Komunitetit të personave me nevoja të veçanta LDK. Pra dëshiroj përgjigje, a është ky Këshill një partiak apo është Këshill që duhet të përfshij të gjitha komunitetet dhe subjektet politike.

z.Avni Fetahu, theksoi, fillimisht rreth Drejtorisë së Arsimit me siguri se është një gabim teknik sepse tani bisedova me z.Agim Blakçori dhe ai është Ushtrues i Detyrës së drejtorit të Drejtorisë së Arsimit. Gjithashtu e mora një informatë nga drejtori i Drejtorisë së Administratës se personi nga Komuniteti Serb ka vendbanim dhe dokumente gjë të cilën mundeni ta verifikoni secili në Zyrën e drejtorit në fjalë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim propozim vendimin në fjalë duke përfshirë edhe korrigjimin e gabimit teknik tek përshtkrimi i emërimit të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, përkatësisht ku thuhet “drejtor i Drejtorisë së Arsimit” duhet të jetë “U.D. i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit”

Pas votimit u konstatua se me 16 vota për, 15 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB

4. Propozim vendimi për dhënien e pronave së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS

z.Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë - DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës keni propozim vendimin e Kryetarit të Komunës së bashku me rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa për dhënien e pronave të paluajtshme dhe pjesëve të rrugëve lokale të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për 40 vite KEDS-it, propozim i cili është bërë duke marrë për bazë Ligjin 04/L-144 për dhënien e pronave në

shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe Ligjin 2003/11 për rrugët. Në mbështetje të nenit 6 të Ligjit nr.04/L-144 dhe nenit 10 në kuadër të të cilit parashihet dhënia e pronave në shfrytëzim për raste të veçanta, paragrafi 1.5 ku thuhet dhënia e pronave të paluajtshme në shfrytëzim me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë, të cilit i përket edhe ky propozim vendim.

Për shkak të zgjedhjeve lokale 2017, 6 muaj para përfundimit të mandatit të përbërjes së Kuvendit të kaluar të Komunës nuk kemi pas të drejtë t'i japim pronat në shfrytëzim afatgjatë, kurse tani kanë kaluar rreth 5 muaj nga konstituimi i organeve dhe trupave të Kuvendit të Komunës në këtë mandat duke përfshirë edhe komisionin përkatës, periudhë gjatë së cilës nga KEDS janë bërë kërkesa për dhënie në shfrytëzim për 34 pjesë të pronave komunale dhe rrugëve publike, prej tyre 32 pjesë të pronave janë nga 9 m² kurse 2 pjesë të pronave janë nga 25 m², që gjithsejtë bëhet fjalë për një sipërfaqe prej 338 m² ku do të vendosen 32 trafo në shtyllë dhe 2 trafo në blindë ku sipas planeve investive për zgjerimin dhe përforcimin e rrjetit distribuiv KEDS do të përfitojnë 20 fshatra dhe lokalitete të ndryshme në të cilat do të vendosen 1 - 2 deri në 4 trafo varësisht prej madhësisë së fshatit dhe dendësisë së popullsisë. Në mbledhjen e KPF-së mbajtur një ditë më parë, janë ngritë pyetje përse KEDS-it po i jepen këto pjesë të pronave në shfrytëzim pa pagesë, e shfrytëzoj rastin të jap këtë sqarim përkatësisht tri arsye, dhe atë, ankesat e qytetarëve nëpër fshatra dhe lokalitete të ndryshme për rrymë me tension të dobët nën çdo mesatare ku ka raste që nuk funksionojnë as stabilimentet elektrike për nevojat familjare e lëre më ato të bizneseve të fushave të ndryshme, pastaj mundësinë e dhënies së pronave komunale pa pagesë për raste të veçanta, për investime në sektorin e energjisë e parashih edhe Rregullorja e QRK-së 23/2013 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme, ku në kapitullin 4, në nenin 20 paragrafi 7 thuhet se Kuvendi i Komunës vendos nëse dhënia në shfrytëzim do të bëhet me ose pa kompensim si dhe mënyra e pagesës. Jo pse ne nuk kemi dëshirë të arkëtojmë të hyra vetanake nga dhënie këtyre pronave në shfrytëzim KEDS-it, gjë të cilën e kemi provuar edhe në mandatin e kaluar ku kemi marrë vendim të tillë me kompensim prej 10 € në muaj për një trafo, mirëpo ka refuzuar një gjë të tillë, mirëpo pastaj ka pasë reagime nga komunitetet dhe kemi qenë të detyruar si Ekzekutiv dhe si Kuvend të rishqyrtojmë vendimin përkatës, përkatësisht të japim të njëjtat prona pa kompensim. Sa për njoftim ne kemi hulumtuar edhe Komunitat tjera të cilat e bëjnë të njëjtën gjë përkatësisht japin prona komunale KEDS-it pa pagesë. Krejt në fund ju ftoj ta votoni këtë propozim vendim me të cilin i jepen në shfrytëzim pjesë të pronave dhe rrugëve publike KEDS-ti për të mirë të qytetarëve të cilëve jua kemi borxh për shkak të dhënies së besimit me anë të votës së tyre.

z.Avni Fetahu, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim ne kemi debatuar gjerë e gjatë edhe në mbledhjen e KPF-së. Ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së duke marrë parasysh rëndësinë e qytetarëve përkatësisht përmirësimin e gjendjes së energjisë elektrike për qytetarët dhe bizneset e atyre lokaliteteve, ne e përkrahim dhënien e këtyre pjesëve të pronave dhe pjesëve të rrugëve publike në shfrytëzim Kompanisë KEDS-it, sipas propozim vendimit përkatës.

z.Fitim Haziri, theksoi, ky propozim vendim i sjellë nga Kryetari i Komunës për dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë në përdhë prej 40 viteve, Kompanisë private KEDS, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së jemi kundër një propozimi të tillë që pronat komunale t'i jepen një Kompanie private pa kompensim ku përfshihen 21 vendbanime në një sipërfaqe totale prej 338 m² e që ndoshta ndokujt mund t'i duke pak por duhet ta dinë të gjithë se kjo nuk është pronë e tyre private, sikur të ishte jam shumë i sigurt se nuk do t'i jepte. E di se do të thirreni në atë se në pronat në fjalë do të vendosen trafostacione, do të vendosen shtylla të betoni ku do të përfitojnë qytetarët e atyre zonave, pastaj do të thoni se ka edhe Komuna tjera që

kanë japë prona KEDS-it pa kompensim, mirëpo po harroni se Kompania në fjalë ka obligim dhe detyrë që të shpërndaj dhe të riparoj rrjetin e energjisë elektrike deri tek konsumatori i fundit, këtë mund ta gjeni edhe në ueb sajtin zyrtar të KEDS. Jemi ndër Komunitat që më së shumti diskriminohemi me furnizim të energjisë elektrike në Kosovë, ndërsa të vie propozimi nga i pari i Komunës që kësaj Kompanie private t'i jepet pronë e paluajtshme në shfrytëzim pa kompensim, është absurde dhe jo ligjore. Neni 14.2 i Ligjit për vetëqeverisje lokale thotë, Komunitat kanë të drejtë të shesin dhe të japin me qira pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme sipas ligjit, dhe në asnjë formë nuk po thotë se Komunitat kanë të drejtë të japin në shfrytëzim pasuri të paluajtshme pa kompensim. Dëshiroj t'ju rikujtoj se kohëve të fundit kemi zyrtarë dhe ish Ministra që janë nën hetime nga Prokuroria për shkak të favoreve që ju kanë bërë kësaj Kompanie.

z.Fatmir Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së do të votoj për, për këtë propozim vendim meqë nga ky propozim preken drejtpërdrejt interesat e qytetarëve dhe çështje - arsye tjera të cilat sigurisht besoj se i ka sqaruar shefi i Grupit në mbledhjen e KPF-së. Unë kam qenë këshilltar i Kuvendi edhe në mandatin e kaluar, dhe ashtu siç e ceku edhe drejtori i DPKGJ, ne kemi marr një vendim të tillë ku kemi caktuar edhe shumën e kompensimit por ka qenë e pamundur të zbatohet sepse KEDS ka refuzuar një gjë të tillë dhe na është dashtë sërish të shqyrtojmë vendimin e marrë, andaj edhe sot do ta mbështesim një propozim vendim të tillë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, kur është në pyetje dhënia e pronë në shfrytëzim Kompanive dhe Ndërmarrjeve private unë mendoj se kjo dukuri është një plagë e kësaj Komune duke marrë për bazë se pronat publike i keni dhënë edhe për ndërtim të shtëpive, dhe sot e asaj dite nga Drejtoria përgjegjëse ende nuk është sjellë ndonjë vendim në asnjë mandat të Kuvendit apo listë e të gjitha pronave publike të Komunës. Kërkoj që këtyre Kompanive të cilat kanë ardh në Kosovë për të shfrytëzuar edhe qytetarët, këtë e them në raport me çmimin e rrymës, veriun e Kosovës etj etj, nuk duhet t'iu jepen lehtë prona publike në shfrytëzim, posaçërisht KEDS-ti sepse është duke i shfrytëzuar qytetarët me çmim të energjisë elektrike, si dhe fundja mendoj se qytetarët dhe Komuna nuk bënë t'i jap prona në shfrytëzim kompanive private sepse nuk e meritojnë. Do të ishte gjë tjetër në qoftë se do të ishte Ndërmarrje publike shtetërore ose Komunale që do të mund të bënin marrëveshje për shfrytëzim reciprok të pronave, por për kompani të huaja private mendoj se nuk është drejtë një gjë e tillë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nuk shoh këshilltarë tjerë të lajmëruar për diskutim, andaj e hedh në votim propozim vendimin në fjalë, duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit u konstatua se me 20 vota për, 9 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozimi vendimi për dhënien e pronave së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS, duke përfshirë edhe rekomandimet nga mbledhja e KPF-së.

5. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës (ish lokali i Shërbimit të Kontabilitetit Shoqërorë)

z.Abaz Llugaliu, drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, në këtë propozim vendim bëhet fjalë për lokalin afarist pronë komunale në rrugën "Zahir Pajaziti" i ndërtuar në parcelën 2858-0, Zona kadastrale Podujevë në sipërfaqe prej 76.95 m², lokal për të

cilin ka qenë një kontratë e mëhershme e lidhur mes Komunës dhe një qytetari që ka qenë fitues i ankandit në atë kohë, i cili ka shlyer borxhet e veta ndaj Komunës dhe ka ndërprerë Kontratën dhe ai lokal ka mbet i lirë për shkaqe të cilat i ceka edhe më parë që kanë të bëjnë me konstituimin e Kuvendit, andaj kërkoj që ta miratoni këtë propozim vendim me të cilin i jepet leja komisionit të zhvilloj procedurat tjera për dhënien në shfrytëzim përmes konkurrencës së lirë me ankand publik.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit politik LDK e përkrahim këtë propozim vendim për miratim paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, përkatësisht lokalit të ish Shërbimit të Kontabilitetit Shtetërorë - SHKSH, në shfrytëzim afatshkurtër, duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi. I'a rikujtojmë Komisionit përkatës i cili e ka punën më të madhe në këtë aspekt për dhënien e pronave në shfrytëzim se duhet respektuar disa parime lidhur me dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim, parime të cilat i kemi përmend disa herë, fjala është për parimin e ligjshmërisë si i padiskutueshëm, parimin e efikasitetit, ngase shumë Komuna shumë herë duke u sjellë si burokratë kanë humbur edhe mundësitë për shtimin e përpjekjeve për investime në favor të qytetarëve të vetë, pastaj parimin e trajtimit të barabartë të palëve, parimin e transparencës, parimin e ruajtjes dhe interesit publik, parimin e ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike komunale si dhe parimin e ruajtjes së ambientit. Gjithashtu ne si Grup do e përcjellim me vëmendje dhënien e pronave në shfrytëzim duke parë se çfarë efekti do të ketë si në punësim ashtu edhe në realizimin e të hyrave që krijohen nga qiraja.

z.Florent Hasani, theksoi, edhe Grupi i këshilltarëve e përkrah këtë propozim vendim që dhënia e pronës përkatëse të kalojë në Komisionin për dhënien e pronave në shfrytëzim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sot po shqyrtojmë një propozim vendim për lokalit i cili ka qenë në një kontratë të lidhur në bazë të vendimit të këtij Kuvendi në mandatin e kaluar. për arsytet e shkëputjes së kontratës në një formë veç u njoftuam dhe në mbledhjen e KPF-së, kontratë të cilën nuk e kam parë se si janë rregulluar obligimet dhe të drejtat mes qiramarrësit dhe qiradhënësit, por e di se çdo kontratë duhet ta ketë një barrë në rastet kur kontrata shkëputet njëanshëm ose në raste tjera përmes një marrëveshjeje. Po ashtu jam në dijeni se qiramarrësi i kaluar e ka degraduar atë vend dhe që ka inkasuar të hyra sepse ka ndarë lokalit në dysh, kurse qiranë e ka paguar Komunës. si shef i Grupit të këshilltarëve të PDK-së kërkoj që i njëjti pronar të mos mund të jetë pjesë e garës për atë lokal sepse ka bërë shkëputjen e kontratës, pikë së pari, dhe mendoj se po të ketë vendim serioz ai person nuk mund të jetë pjesë e garës. Elementi i dytë i kësaj pike e që më bënë përshtypje është se në mandatin e kaluar ne kemi caktuar një bazë minimale si për ish "Hotel Llapin" ashtu edhe për këtë lokal, andaj konsideroj se ne sot duhet të vendosim një bazë minimale këtu, nën sa nuk mund të lëshohet ai lokal me qira sepse ne duhet ta dimë sa duhet të jetë ajo e hyrë e që kontrata e fundit ka qenë 1250 €, që mendoj se ju jep element garuesve që pastaj të fitoj më i miri. Ne jemi në dijeni se Kuvendi i Komunës e jep dritën e gjelbër dhe jemi për dhënien e pronave të komunës në shfrytëzim ashtu siç jemi për mbikëqyrjen dhe inkasimin e të hyrave në mënyrë sa më korrekte dhe strikte prej atyre që ofertojnë. Lokali është në qendër të qytetit, arsyetim dhe pyetjes se kush i ka dhënë të drejtë atij personi të ndaj atë lokal, nga një të bëjë dy lokale, besoj se askush nuk mund të japë, kur jemi në dijeni se për bazën e kontratës ku qiramarrësi nuk ka të drejtë të tjetëron lokalit, të ndërhyjë, ta lëshoj me qira po ai vetë dhe çështje tjera, unë e di se në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore ai person nuk e ka pas asnjë të drejtë të bëjë një gjë të tillë. Nuk jam në dijeni se ku ka qenë drejtoresha e Drejtorisë së Inspeksionit në mandatin e kaluar kur kemi parasysh se ai lokal është në qendër dhe pothuajse çdo ditë ka kaluar andej, pastaj e ka parë se ai lokal është ndarë në dysh

dhe ka funksionuar dy biznese, pastaj drejtoresha e Drejtorisë së Inspeksionit e ka ditë se të gjithë qytetarët – banorët janë dal jashtë për shkak se është thyer shtylla kryesore e objektit e cila ka qenë në mes të lokalit dhe janë rrezikuar të gjithë banorët, pastaj ka qenë në dijeni se qiraja nuk është nën 1200 € dhe ka nënshkruar një marrëveshje me vëmendje të plotë për një afat të caktuar, mirëpo edhe përkundër gjitha këtyre që u thanë ta harroni se ne sot po marrim një vendim për dhënien në shfrytëzim të atij lokali për 15 vite ku pastaj të garoj vet dhe ta merr për 200 €. Unë e di se me shumicën e votave ky propozim kalon, por kërkoj që Komisioni për dhënien e pronave në shfrytëzim, të paktën nga anëtarë nga radhët e PDK-së, të verifikoj kontratën e fundit të lidhur dhe atë të shkëputur mes qiramarrësit dhe qiradhënësit për lokalin në fjalë, përkatësisht i nderuar z.Arbër Blaku, para se të futeni në komision kërkojeni këto dokumente qoftë përmes qasjes në dokumente zyrtare qoftë përmes rrugës zyrtare, pastaj duhet të shikohen në Drejtorinë përkatëse shlyerjen e të gjitha borxheve sipas kontratës por duke përfshirë edhe ato të rrymës, ujit mbeturinave etj për atë kontratë, mandej kërkoj që kategorikisht të mos jeni pjesë e komisionit në rast se i njëjti person është garues dhe ofertues për marrjen sërish në shfrytëzim të atij lokali, pra të paktën kërkoj këto që i ceka nga Ju si koleg dhe si anëtar i subjektit politik që i takoj dhe unë, përndryshe jam në dijeni se në mënyrë demokratike, me shumicë të votave mund të bëjmë mirë dhe keq, por unë e di se këtu dhe çdo kund tjetër ka dy lloje të njerëzve, ata që punojnë mirë dhe ata që punojnë keq, me tendenca dhe pa tendenca.

Pra i nderuar Kryesues i Kuvendit, jam që ky lokal të jepet në shfrytëzim, dhe do të votojmë për, është kërkesë që para hedhjes në votim të caktohet baza e qirasë sepse në të kaluarën janë eliminuar ofertues të dytë dhe të tretë me 900 – 950 €, andaj mendoj se është mirë të caktohet një çmim fillestar në mënyrë që të jemi në dijeni përafërsisht se sa do të krijohen të hyra për Komunën nga ajo qira. Por nuk mund të bëjmë lëshime që të njëjtit njerëz të lëshojnë me qira prona publike, siç është rasti i “Mileniumi 2000”, qira mbi qira, pastaj nuk mund të tërhiqen nga oferta shembull, baba, dhe pastaj të shkoj në garë nipi ose vëllau, mandej mund të ketë ndërhyrje familjare në atë proces, kështu që ne si Kuvend duhet të dakordohemi këtu që çështje të tilla t’i përcjellim si shkojnë. Jam që t’i hapim mundësi çdo investitori, por duhet të kemi një standard, qoftë edhe 100 € nëse është qiraja për atë lokal është mirë të lidhet një marrëveshje me atë biznesmen ose person i cili i qëndron mbrapa dhe e respekton kontratën dhe që punëson shembull 2 persona, por jo të bëhen shaka duke menduar nga ndokush që njëherë ka eliminuar ofertuesit tjerë tash mendon se do të jetë përfitues sërish, lojëra të cilat janë shumë të ulëta. Kështu që ne bazën minimale nuk e kemi sot, të drejtën e ofertimit e kanë të gjithë pa përjashtim dhe me çfarëdo shume të mjeteve, unë jam që t’i caktohet baza minimale e ofertimit për atë lokal, dhe po të isha Kryesues i Kuvendit do ta tërhiqja këtë dokument dhe do të kërkoja nga ai që e ka sjellë t’i caktohet baza minimale e ofertimit nën sa nuk mund të ofertoj askush sepse mendoj se nuk mund të sjell askush çfarëdo dokumenti në Kuvend dhe ne të jemi vetëm legjitimues për njerëz tendencioz.

z.Abaz Llugaliu, drejtor i DPKGJ, theksoi, sqarim të shkurtër për këshilltarin parafolës z.Rafet Llapashtica rreth caktimit të çmimit ofertues, Rregullorja 23/2013 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në nenin 7 thuhet, përgatitja për mbajtjen e ankandit publik, njoftimi për ankandin publik për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës bëhet nga Komisioni përgjegjës i Komunës në afat prej 30 ditëve para shpalljes së ankandit, njoftimi për ankand publik përfshin, ndër të tjera, është edhe çmimi fillestar i pronës që është objekt i dhënies në shfrytëzim. Unë për hir të transparencës po e cekë se çmimi fillestar i lokalit në fjalë në ankandin paraprak ka qenë 850 €, kështu ka qenë qiraja edhe nga Banka Private e Biznesit – BPB, tani nuk besoj se do të shkoj më poshtë se kaq sepse

konkurrenca e cakton edhe çmimin e qirasë. Pastaj ne si Komision në mandatin e kaluar kemi pasë edhe kritika për shkak se ky lokal është dhënë në shfrytëzim me një çmim më të lartë se ish lokali “Hotel Llapi”, mirëpo ka qenë konkureca ajo që e ka ngritë çmimin nga 850 € në 1230 € dhe për shkak të këtij çmimi ka ardhë deri tek ndërprerja e kontratës sepse shfrytëzuesi i qirasë nuk ka mund ta përballoj por e ka shlyer borxhin dhe e ka shkëputë kontratën. Në ligjin përkatës, nuk kemi ndonjë dispozitë në bazë të cilën mund t’i japim ndonjë penallti atyre që i shkëpusin kontratat, përndryshe do të venim ndëshkime për ata persona të cilët i shkëpusin kontratat e tilla.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, rreth kësaj çështje besoj se të gjithë jemi që të përfillen rregullat dhe dispozitat ligjore për dhënien e pronave në shfrytëzim. Komisioni përkatës është i ngritur dhe është ai i cili duhet të respektoj ligjin dhe aktet nënligjore përkatëse rreth kësaj pike, andaj e hedh në votim këtë propozim vendim duke përfshirë edhe rekomandimet nga mbledhja e KPF-së e mbajtur një ditë më parë.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës (ish lokali i Shërbimit të Kontabilitetit Shoqërorë), duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

6. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Llapashticë e Poshtme

z.Abaz Llugaliu, drejtor i DPKGJ, rreth kësaj pike e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, bëhet fjalë për parcelat kadastrale nr.704 në sipërfaqe prej 5630 m² dhe nr.706-0 në sipërfaqe prej 4307 m² në fshatin Llapashticë e Poshtme, me kulturë kullosa, vend i cili është afër Hib Petroll.Parcelat në fjalë i ndan një rrugë por që mund të bashkohen dhe rruga të zhvendoset. Kemi menduar se është një parcelë e përshtatshme për zhvillimin e bizneseve të ndryshme për të cilën edhe ka pasë të interesuar e që besoj se do të ketë edhe ofertues dhe do të jepet në shfrytëzim, në mënyrë që ajo hapësirë të mos mbetet djerrinë dhe me mbeturina siç është aktualisht, por të shfrytëzohet për biznes dhe të kontribuoj në të hyrat vetanake të Komunës dhe në ngritjen e punësimit në Komunën e Podujevës.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, unë mendoj se ajo pjesë duhet të shikohet sepse aty është e ndërtuar një Odë e fshatit apo lokal që komunitetit e ka ndërtuar, është hapësirë gjelbëruese, nuk ka mbeturina, është e shfrytëzueshme prej qytetarëve dhe banorëve të atij lokaliteti për aktivitete sportive, dhe po besoj që ajo hapësirë nuk duhet të jepet në shfrytëzim. Ky është mendim i imi personal sepse ajo hapësirë i duhet për shfrytëzim komunitetit edhe pse është pronë publike duhet të mbetet në të mirë të Komunitetit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, bëhet fjalë për dy ngastra kadastrale në sipërfaqe prej mbi 80 ari, unë e kam shikuar këtë dokumentacion dhe nëse nuk është gabim teknik aty figuron klasa e 2-të, dhe siç jemi në dijeni janë disa kufizime në bazë të klasës së tokës, për ndërtime të larta ose objekteve madhore biznesore, pastaj është procedura e lejes që duhet të merret në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila duhet t’i kryej obligimet e veta procedurale.

Ne dje në mbledhjen e KPF-së në parim e kemi mbështetë këtë propozim vendim mirëpo nuk kemi qenë në dijeni saktësisht rreth asaj që u tha nga këshilltari parafolës. Tani në një mënyrë jemi paksa të hezituar rreth kësaj çështje për shkak se aty qenka një Odë e ndërtuar nga banorët e fshatit dhe nëse ne tani japim në shfrytëzim ndonjë biznesi atëherë bëjmë pengesa të dyanshme,

po ashtu është kërkesë edhe komunitetit që ajo hapësirë të shfrytëzohet nga vetë Komuniteti i fshatit, mirëpo ne tani duhet të marrim një vendim se si do të veprojmë më tutje, pra mbetet qëndrim i këshilltarëve të Kuvendit se si do të votojmë dhe të zgjidhim këtë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, mendoj se tani jemi në një pozitë kontroverse kur kemi të bëjmë me interesin e Komunitetit dhe interesin e bizneseve apo nepotizmit dhe klientelizmit, unë kështu e shoh. Prona në fjalë është në fshatin Llapashticë të Poshtme dhe mendoj se nuk është marrë pëlqimi i Komunitetit, të cilët në atë pronë tash u njoftuam se paskan në shfrytëzim një objekt, pa marr parasysh, Komuniteti qenka shfrytëzues i atij objekti, unë mendoj se gjithmonë duhet t'i japim Komunitetit përparësi dhe asesi nuk bën të marrim vendime pa pasur pëlqimin e Komitetit për një gjë të tillë, kështu që mendoj dhe i propozoj Grupit të këshilltarëve të LVV-së që mos të kalohet me vota ky propozim vendim. Gjithashtu është përgjegjësi edhe e Komisionit për çështje të tilla që duhet të jetë shumë seriozë në trajtimin e problematikave të tilla sepse kemi të bëjmë me interesin e drejtpërdrejtë të qytetarëve.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, meqë prona në fjalë është publike dhe vetëm rruga i ndan me varrezat e fshatit të cilat pothuajse janë të stërngarkuara, ajo pronë në të ardhmen mund të shndërrohet në hapësirë përkatësisht të përdoret për varreza. Pra është e domosdoshme të mos jepet në shfrytëzim prona në fjalë sepse pothuajse e tërë lagja është përreth asaj prone madje hyrje daljet e secilës shtëpi janë përreth saj, në të kundërtën do të jetë diçka që do të shkaktoj shumë probleme dhe pengese tek qytetarët.

z.Patriot Rudari, theksoi, edhe unë e përkrahi z.Mirsad Kamerollin, unë kam të afërm në atë lokalitet dhe jam në dijeni se objekti që u cek është ndërtuar para rreth 3 viteve nga ana e Komunitetit. Përse e ka lejuar Inspeksioni të ndërtohet, kurse tani të rrënohet ai objekt nuk është e logjikshme disi. Pastaj janë edhe varrezat afër asaj prone dhe kurrresi nuk bënë të jepet në shfrytëzim ajo parcelë. Nuk di përse kanë vendos të sjellët një propozim i tillë kur një objekt veç është i ndërtuar në atë hapësirë.

z.Abaz Llugaliu, drejtor i DPKGJ, theksoi, është n'pyetje rreth 1 hektar, objekti që është ndërtuar për pritje të atyre që shkojnë për ngushëllime në rastet e vdekjeve, është objekt i ndërtuar pa leje por nuk e kemi ndërmend ta rrënojmë atë. nuk do të thotë që e tërë hapësira prej 99 ari do të jepet për biznes, objekti dhe një pjesë e asaj hapësire do të mbetet ashtu dhe do të përdoret nga banorët e fshatit. Përndryshe ne vazhdimisht jemi kritikuar përse nuk i japim pronat komunale në shfrytëzim, por nuk mund të japim prona, shembull, që janë në Kokorrovicë sepse për atje nuk kemi të interesuar fare, por ata që merren me biznes kërkojnë prona ku mund të zhvillojnë biznes, në këtë rast ajo pronë është afër rrugës magjistrale, ka në dispozicion gjithë infrastrukturën dhe besoj se do të ketë ofertues. Pra ky ka qenë interesi i këtij propozim vendimi, kurse prapavija tjera nuk ka.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, unë pajtohem që duhet të përkrahen bizneset, por nuk mund të përkrahen bizneset dhe të favorizohen me pronë publike si në rastin konkret ku në gjithë fshatin Llapashticë është vetëm 1 hektar pronë publike, për të cilën them se është më mirë të shndërrohet në ndonjë terren sportiv apo atë që e ceka që pas 3-4 viteve do të ketë nevojë të shndërrohet në varreza. Kështu që unë mendoj se konfiguracioni i asaj prone është jashtëzakonisht shumë e parcializuar, pastaj është Oda në mes të asaj prone e që është e pamundshme të përkrahet ndokush për biznes, kështu që duhet të vendosim në favor të Komunitetit të cilët më kanë kontaktuar dhe kanë kërkesë që ajo pronë të mos jepet në shfrytëzim, andaj edhe unë ju bëjë thirrje gjithsecilit prej juve mos me përkrahë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, sa vite ka që është premtuar zona industriale në lokacionet ku keni me hektarë prona publike, kurse tani ju keni vërsul një fshati për me bë biznes aty. Këtu ka vetëm klientelizëm asgjë tjetër.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ajo që parafolësi e tha, mund të jetë vetëm konstatim i tij, kurse nga vitit 2018 në këtë Kuvend është marrë vendim për Zonën industriale dhe ai Vendim qëndron ende.

z.Arbër Blaku, theksoi, si anëtar i Komisionit për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, kërkoj që të kthehet edhe njëherë në rishqyrtim kjo pikë e rendit të ditës për shkak se si komision pastaj mund të jemi në pozita të vështira me Komunitetin e atij fshati të cilët ndoshta nuk dëshirojnë ta japin atë pronë në shfrytëzim. Lus që ky propozim vendim të tërhiqet nga rendi i ditës përkatësisht të rishqyrtohet edhe njëherë. Po ashtu rreth asaj që këshilltari z.Mirsad Kamerolli e ceku, kërkoj që të mbledhen peticione ose të ngjashëm nga ai Komunitet se çka dëshirojnë ata të bëjnë në atë hapësirë, edhe pse e njëjta është pronë komunale mendoj se duhet të jetë pëlqimi i tyre, kështu që edhe njëherë kërkoj që kjo pikë të tërhiqet – shtyhet për ndonjë seancë tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit, me pajtim të shumicës së këshilltarëve jep 5 minuta pauzë

Pas pauzës, mbledhja rifillon me konstatim të kuorumit ku prezent në sallë ishin 27 këshilltarë të Kuvendit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, për momentin të pranishëm janë 27 anëtarë/e të Kuvendit, por ndër kohë mund të arrijnë edhe të tjerë, mund të vazhdojmë me punë. E vazhdojmë ku mbetëm tek pika 6 e rendit të ditës për të cilën pati një kërkesë për shtyrje përkatësisht rishqyrtim në një prej seancave të radhës. Fjalën e kanë shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit.

z.Avni Fetahu, theksoi, në konsultim me shefat e Grupeve të këshilltarëve, u dakordua që propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Llapashticë e Poshtme, sipas pikës 6, të shtyhet për një prej seancave të radhës. Njëkohësisht rikujtojmë se herëve tjera me rastin e miratimit të rendit të ditës ose edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa të adresohen çështjet për arsye se edhe ne si Kuvend nuk dalim mirë në raste të tilla kur rendi i ditës veç është i miratuar, kurse pastaj kur vijmë në një pikë të caktuar, diskutohet rreth asaj se a është dashtë apo jo të sjellët një propozim i tillë. Gjithashtu ju rikujtojmë se me mos votimin e këtij propozim vendimi, nuk do të thotë që ne në një formë po miratojmë një objekt të ndërtuar pa leje. Pra kjo situatë nuk është gjë shumë e mençur edhe prej anës tonë si Kuvend, por të mbetet mësim për herat tjera.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se kjo që u tha nga parafolësi është dakordimi mes shefave të Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit. Nëse nuk ka të interesuar tjerë për të marrë fjalën, e hedh në votim propozimin që propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Llapashticë e Poshtme sipas pikës 6 të rendit të ditës të shtyhet për rishqyrtim në një prej seancave të radhës të Kuvendit të Komunës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozimi i dakorduar i Grupeve të Këshilltarëve që propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Llapashticë e Poshtme, të shtyhet për rishqyrtim në një prej seancave të radhës.

7. Propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Ministrisë së Punëve të Brendshme

z.Abaz Llugaliu, drejtor i DPKGJ, në fjalën hyrëse theksoi, lidhur me këtë propozim, kemi të bëjmë me një kërkesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila ka kërkuar nga Komuna lokacion për ndërtimin e një baze të pompimit për ujësjellësin në pikën kufitare në Merdar. Kërkesa është për parcelën nr.207-0, rreth 50 m² që gjendet në oborrin e shkollës së vjetër. Ky propozim vendim ka marrë mbështetjen edhe të KPF-së dhe i është rekomanduar edhe Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, andaj meqë kemi të bëjmë me dhënie të pronës në shfrytëzim për raste të veçanta ku ligji e lejon një gjë të tillë pa iu nënshtuar procedurës së konkurrimit, kërkohet nga ky Kuvend të mbështetë këtë propozim vendim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

8. Propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi” – Njësia Podujevë

z.Abaz Llugaliu, drejtor i DPKGJ, paraqiti fjalë hyrëse, ndër të tjera theksoi, kemi të bëjmë me dhënie në shfrytëzim afatgjatë po ashtu për raste të veçanta, KRM “Pastrimi” – Njesisë Podujevë. Siç jeni në dijeni në këtë Kompani publike Komuna e Podujevës është aksionare dhe shefi – drejtori i Njesisë së Podujevës ka paraqitur kërkesë të kahmotshme për caktimin e një lokacioni në mënyrë që të ndërtohet baza e njësisë. Po ashtu është shumë e qëlluar që kjo Kompani të hiqet nga qyteti për shkak të erërave të ndryshme, e që kemi edhe kërkesë nga banorët përreth lagjes tek ish thertorja ku ka selinë kjo Kompani – Njësi, andaj unë besoj se pa hezitim duhet të mbështetet ky propozim vendim. Parcela është në fshatin Dumnicë e Poshtme, afër tregut të kafshëve.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi” – Njësia Podujevë, duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur nj ditë më parë.

9. Të ndryshme

z.Florent Hasani, theksoi, kemi qytetarë të cilët nuk pajtohen me disa emërime të disa rrugëve të ndryshme në Podujevë, mendojnë se janë anashkaluar njerëz me ndikim dhe me kontribut më të madh, prandaj kanë pyetje se kur do të formohet komision për shqyrtimin e atyre ankesave.

z.Arbër Blaku, theksoi, e kam një kërkesë të Komunitetit të fshatrave të Orllanit, kërkesë e cila është dërguar në shumë adresa të këshilltarëve të Kuvendit, qoftë të pozitës ashtu edhe të opozitës. Kërkesa është adresuar në disa pika ku paraqiten kërkesa të ndryshme për infrastrukturë dhe gjëra tjera. Kështu që unë e kam shtypë atë kërkesë në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, jo për poena politik por për të dërguar në vend kërkesën e tyre, ta dorëzoj ty i nderuar Kryesues i Kuvendit që pastaj t’i ta përcjellësh më tutje tek Drejtoritë përkatëse.

z.Bajram Ajeti, theksoi, edhe ne si Grup i këshilltarëve kemi marrë kërkesën e një OJQ-e e cila po trajton problemet e Komunitetit të fshatrave të Orllanit, qoftë me rrugët qoftë me probleme tjera, prandaj ne nuk po dorëzojmë kopje sepse është ajo e njëjta që këshilltari parafolës e dorëzoj tek Kryesuesi, por e përkrahim fuqishëm Komunitetin e fshatit Orllan dhe kërkojmë që administrata komunale të shqyrtoj problemet e tyre dhe të merret seriozisht me ato probleme të paraqitura në kërkesë të cilat i kemi analizuar dhe mendojmë se janë të arsyeshme dhe që Komuna me një planifikim të mirëfilltë mund të bënë zbatimin e tyre.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, kërkojmë Raport pune, për seancën e radhës nga: Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Inspeksionit, si dhe kërkojmë sqarim me shkrim në afat ligjor lidhur me përfundimin e punëve të Palestrës afër Gjimnazit aktual. *(kërkesën ia dorëzon në formë të shkruar Kryesuesit të Kuvendit).*

znj.Floretë Zejnullahu, theksoi, kam pyetje për Ekzekutivin e Komunës lidhur me një rrugë në fshatin Lladoc prej nga vi unë, përkatësisht rruga “Nezir Kiçmari” ose siç njihet Lagja e Kiçmarve. Në vitin 2007 kur është asfaltuar rruga kryesore e fshatit, Lagja në fjalë ka mbetur anash, pastaj në vitin 2016 banorët e asaj Lagjeje kanë bërë kërkesë në Komunë duke bashkëngjitur edhe projektin e rrugës të hartuar me vetëfinancim. Vlen të theksohet se ajo rrugë është në gjendje të mjerueshme dhe vështirëson qarkullimin e banorëve të atij lokaliteti e sidomos gjatë reshjeve të shiut, andaj pres përgjigje nga Ekzekutivi i Komunës se kur do të ndërmerret diçka në lidhje me këtë çështje.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, kam pyetje për dy drejtor të cilët nuk janë të pranishëm këtu në sallë, mirëpo si do që të jetë, duke u bazuar në procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e mbajtur më 09 mars 2018 me të vetmen pikë të rendit të ditës lidhur me vërsimet në territorin e Komunës, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit z.Faik Muçiqi, si dhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z.Vezir Januzi, kanë pohuar se Komisioni për vlerësimin e dëmeve është duke punuar në terren, madje zotëri Muçiqi e ka theksuar disa herë që së shpejti do të kemi një raport të këtij Komisioni, si dhe ka premtuar se do të sillet hiç më larg se në seancën e ardhshme. A mund të na tregoni përse ende nuk e kemi një raport për vlerësimin e dëmeve, edhe pse kanë kaluar dy muaj, presim përgjigje në afat ligjor.

z.Patrot Rudari, theksoi, kam kërkesë për një rrugë e cila është mjaft e rrezikshme, fjala është për rrugën Podujevë – Shajkoc, për të cilën kam biseduar edhe para rreth 2 viteve me drejtorin e Drejtorisë përkatëse. Tek udhëkryqi që lidh atë rrugë me fshatin Sfeqël, është një objekt privat i vjetër i cili pengon shumë pamjen e atyre që kyçen në atë rrugë, andaj nëse nuk është e mundur që Komuna të rrënojë atë objekt të paktën bile murin (gardhin) që është aty pranë të ndërmarr diçka për ta rrënuar në mënyrë që të lirohet dukshmëria e plotë e shoferëve. E them këtë sepse ka pas disa aksidente me fatalitet në atë udhëkryq për shkak të këtij objekti dhe atij muri.

z.Blerim Maqastena, theksoi, pyetje rreth investimeve në shumë prej 60,000.00 € në parqet nacionale përgjigje të cilën nuk e kam marrë enda nga ana e drejtorit përkatës dhe deri sa nuk marrë përgjigjen në fjalë për parqe nacionale, e që nuk ka të tilla në Llap përveç Liqenit të Batllavës që ka dashtë të bëhet, sërish kërkoj nga drejtori të përgjigjet ku janë investuar 60,000.00 €, që ju i quani në parqe nacionale, përgjigje që mund të mos e jepni, por unë do të shtroj këtë pyetje gjatë gjithë vitit.

Çështja tjetër ka të bëjë me mua personalisht, më vie keq prej këshilltarëve të LVV-së, por unë nuk do të jem më pjesë e Grupit të këshilltarëve të LVV-së, tani e tutje do të jem pjesë e Partisë Social Demokrate – PSD.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, edhe pse më 28.02.2018 kemi kërkuar raportin e prokurimit, të njëjtën gjë e kërkojmë edhe për mbledhjen e ardhshme. Po ashtu dua të cekë edhe një problem tjetër, fjala është për një pjesë të qytetit, mbrapa lumit Llap tash e një kohë mungon ndriçimi përkatësisht vetëm poçet elektrik e që nuk është një kosto shumë e lartë, si dhe për shkak të shumë mbeturinave që hudhen në atë pjesë qytetare të shumë po pësojnë nga qentë endacak, andaj lus ta keni parasysh sepse është çështje me rëndësi.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, sigurisht që unë jam përgjigj në pyetjen rreth investimeve në parqe nacionale, por këshilltari z.Blerim Maqastena sigurisht nuk është ndarë i kënaqur tërësisht me përgjigjen time, konkretisht unë jam përgjigj njëherë, por këshilltari në fjalë ka shtruar sërish pyetjen e njëjtë atëherë unë i kam thënë se nuk përgjigjem dy herë për të njëjtën pyetje, megjithatë sërish sot po jap sqarime për të njëjtën çështje. E kam sqaruar se ne jemi të obliguar ta zbatojmë planin kontabël të cilin e ka lëshuar Ministria e Financave për të gjitha Institucionet komunale, pastaj e kam thënë se ne kemi investuar në hapësirat publike të Komunës së Podujevës të cilat janë koduar në kodin – parqe nacionale. Mundësit për t'i koduar këto investime në shumë 60,000.00 € kanë qenë: 1-është një kod ekonomik ku thuhet, *toka*, 2-kodi tjetër ekonomik ku thuhet, *rregullimi i lumenjve*, 3-kodi ekonomik, *parqe nacionale*, dhe 4-kodi ekonomik, *pylltaria*, andaj me planin kontabël na është dhënë kjo mundësi që ta shpenzojmë këtë investim dhe në mesin e këtyre 4 kodeve ekonomike ka mbete të përzgjedhim ne se cili kod është më adekuat, në këtë situatë në këtë investim e kemi koduar në kodin më adekuat, parqe nacionale dhe këtu e kam raportin detaj se ku janë investuar mjetet në fjalë ku thuhet, 858 € është hartuar projekti zbatues për këto hapësira publike, pastaj OE “Vëllezërit Hyseni” kanë bërë ndërtimin e hapësirave publike që gjenden afër QKMF-së Podujevë, mandej janë mbjellë lule dhe të tjera, ku ka pas nevojë në hapësirat publike gjelbëruese në qytet dhe në parkun e qytetit, pra këtu janë edhe shumat e shpenzuara dhe nëse jeni të interesuar unë komplet jua jap këtë raport detaj, raporte të cilat nuk përfshihen në raporte financiare për shkak se janë shumë voluminoze ku afërsisht munden me qenë mbi 4000 faqe. Pra raportet detaje tregojnë shumën e shpenzuar, ku është punuar dhe kush është paguar për atë punë, plan të cilin e bën Ministria e Financave për të gjitha Agjencionet, Komunitat dhe Ministrinë, pra me këtë plan ne kemi pasë 4 mundësi që ne është dashtë të zgjedhim njërin prej këtyre kodeve që ta fusim projektin të cilin e ceka.

z.Bajram Ajeti, theksoi, po ndërlidhem me parafolësin, kërkoj që në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të jepen përgjigjet e qarta dhe të detajuara në mënyrë që anëtarët përkatësisht përfaqësuesit e subjekteve t'i kenë të qarta të gjitha për çka janë të interesuar. E them këtë me qëllim që neve këtu të mos na zgjaten mbledhjet duke u paraqitur detaje, dhe në këtë aspekt mbledhjet dhe puna e Kuvendit pastaj do të jetë më efikase.

z.Agim Behluli, theksoi, dëshiroj të paraqesë një kërkesë të qytetarëve përkatësisht banorëve të Lagjes në rrugën “Ali Ajeti” ku edhe unë jam banorë aty, fillimisht përgëzoj Komunën që në vitin e kaluar ka rregulluar disa shkallë me rrethoja – mbajtëse metalike në rrugën që të shpie tek rruga për fshatin Balloc ose siç njihet tek ura e Shtedimit, mirëpo aty para një kohe ishte një aksident ku një veturë ka shkatërruar në tërësi ato rrethoja – mbajtëse, andaj do të ishte mirë të vendoseshin sërish ato rrethoja.

Po ashtu është e dhe një kërkesë e banorëve përreth fushës së futbollit e cila është ndërtuar në atë lagje, fjala është për hapësirën përreth fushës ku herë pas here hudhen mbeturina, andaj kërkesa është që të largohen mbeturinat nga ajo hapësirë si dhe brenda mundësive të rregullohet ajo hapësirë.

z.Blerim Maqastena, theksoi, unë drejtorin e DBF e pyeta shumë singërisht, parqet nacionale, pse të quhen kështu kur nuk kemi parqe nacionale, përse mos të quhet parku i qytetit, pastaj specifikat ku është investuar, e jo vetëm shabllon ashtu të përfshihet në raport shuma prej 60,000.00 €, as nuk ka kontratë, as nuk ka faturë e të tjera, prandaj ne kemi të drejtë të shqetësohemi për raste të tilla. Ju mund t'i hidhni hi syve qytetarëve por mua jo, andaj ju lus të specifikoni në tërësi ato shpenzime, në të kundërtën do shtroj pyetje edhe në mbledhjen e radhës.

z.Hasan Ajeti, theksoi, lidhur me çështjen e cekur nga këshilltari z.Patriot Rudari, nëse ai i është referuar udhëkryqit ku lidhet fshati Sfeqël me fshatin Balloc, fatkeqësisht aty është shumë e vërtetë se ka pasë aksidente me fatalitet me viktime, mirëpo sa unë jam në dijeni ajo është pronë private si dhe rruga Podujevë – Shajkoc është rrugë rajonale, por kjo nuk do të thotë se largohet përgjegjësia askënd. Unë fillimisht mendova që këshilltari i cekur e ka fjalën për fshatin Shajkoc sepse ashtu iu referua në fillim, por nëse është fjala për vendin që e ceka, vërtetë është shqetësues, dhe si do që të jetë unë e ndaj si shqetësim sepse fatkeqësisht qëndron ajo që u tha, si dhe ajo çështje duhet të rregullohet qoftë nga organet komunale qoftë nga organet e nivelit qendrorë.

z.Fatmir Rudari, theksoi, edhe unë dëshiroj të ngriti temën rreth udhëkryqit që lidh Fshatrat Sfeqël – Balloc, udhëkryq i cili nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është shpall – cilësuar si udhëkryq i fataliteteve. Është e vërtetë që aty kanë ndodh shumë aksidente me fatalitet dhe mund të ndodhin çdo ditë raste të tilla. Këshilltari parafolës nga radhët e LDK-së e tha që ajo rrugë është rajonale, ashtu është dhe është në menaxhimin e Ministrisë, mirëpo jemi në dijeni se pronat janë në menaxhim të Komunës. Këshilltari z.Patriot Rudari e tha se në atë hapësirë është një objekt, në fakt është një objekt i ruajtjes së ushqimit të bagëtive (pleme siç quhet në popull) e cila e pengon shumë dukshmërinë gjatë kycjes së vozitësve në atë rrugë kryesore e që konsideroj se paraqet shkak për aksidente, andaj nëse ka mundësi të bisedohet me atë familje dhe të ndërmerret diçka në këtë drejtim, do të ishte gjë e mirë.

z.Blerim Maqastena, theksoi, dëshiroj të ndërlihem në këtë temë që ka të bëjë me udhëkryqin që lidhë fshatrat Sfeqël – Balloc, për shkak se pothuajse çdo ditë kaloj andej dhe me të vërtetë është një udhëkryq shumë i rrezikshëm, madje nuk e besoj që ka ndokund në Llap më të rrezikshëm.. do të ishte mirë t'i sugjerojmë Drejtorisë së Infrastrukturës që në atë vend të bëhet një rreth, pengesë apo diçka e ngjashme në mënyrë që të parandalohen aksidentet eventuale.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marr fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:45

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0038882/18
Podujevë,
11 maj 2018**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**